



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 11 NËNTOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 28.10.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe” *(nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës dhe nenet 28, 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor” *(neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektvendimi “Për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese (*vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 12.02.2018. Kushtetuta, ligji, Rregullorja, votim i fshehtë me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Koha e votimit

6. Projektvendimi “Për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese (*vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 4.3.2019. Kushtetuta, ligji, Rregullorja, votim i fshehtë me 3/5-ta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Koha e votimit

7. Projektvendimi “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” (*neni 78 i Kushtetutës, nenet 55 dhe 111 të Rregullores, votim i fshehtë me shumicë të thjeshtë*)

Raporti i Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Koha e votimit

8. Njoftimi/miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 25 nëntor – 13 dhjetor 2019 (*neni 27, pikat 3 dhe 4 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë*)

9. Njoftim/miratimi i kalendarit të veçantë të shqyrtimit të projektligjit të buxhetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje me të (*neni 79, pika 2, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë*)

10. Për votim:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës” (*nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute*)

11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (*neni 45 i Rregullores*)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Të futet media brenda!

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(*Pasi lexon rendin e ditës.*)

Lidhur me procesverbalin, a ka vërejtje?

Po, urdhëroni!

Ralf Gjoni - Faleminderit, zoti Kryetar!

E ndiej si detyrë morale dhe kushtetuese që për procedurë të ngre një çështje që e gjykoj shumë të rëndësishme. Sot ky parlament ndodhet përballë një procesi kushtetues të përmasave të jashtëzakonshme. Ne sot vihemi përballë përgjegjësisë kombëtare për të zgjedhur anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Besoj se të gjithë deputetët bashkohen në dëshirën për ta parë atë gjykatë sa më funksionale sa më shpejt që të jetë e mundur. Unë nuk jam as konstitucionalist, as jurist, por 2-3 gjëra i kuptoj qartazi.

Zoti Kryetar, Kushtetuta është shumë e qartë për sa u përket procedurave që duhet të ndiqen për zëvendësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese. Unë besoj se ju dhe ekspertët juridikë të Kuvendit kanë detyrimin t’u shpjegojnë deputetëve se mbi bazën e cilës procedurë po zhvillohet debati sot. Deri dje në darkë jemi njoftuar se, sipas Rregullores së re të Kuvendit, nuk ka debat kur votimi për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese është i fshehtë.

Të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve, më korrigjoni nëse gabohem. Sot në mëngjes në minutën e fundit njoftohemi se ka debat, dhe deputetët mund t’i regjistrojnë emrat e tyre për të bërë debat, për mënyrën se si do të zgjidhen anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Zoti Kryetar, e kam detyrim që t’ju bëj me dije, por t’u bëj me dije edhe të gjithë kolegëve të mi të opozitës këtu, sepse, me sa shikoj, kolegët socialistë e kanë të qartë drejtimin që do të marrin, që përzgjedhja e kandidatëve duhet të bëhet në mënyrë strikte sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, që kanë qenë pjesë e ndryshimeve të reformës në drejtësi.

Unë nuk e kuptoj se mbi bazën e cilës procedurë po zhvillohet votimi sot.

1. A mund të na e shpjegojë dikush që është konstitucionalist?

2. Ku janë ekspertët që janë marrë me draftimin e reformës në drejtësi dhe të na shpjegojnë pse gjendemi sot në një vakuum

institucional dhe në një vakuum procedural kushtetues?

3. Përse nuk janë sot këtu përfaqësuesit e EURALIUS-it dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë që janë marrë me reformën në drejtësi dhe të na sqarojnë se çfarë po bëjmë dhe për çfarë po votojmë në parlament?

4. Zoti Kryetar, nuk mundeni që t'i çoni për votim pa qartësi procedurale.

E fundit, përse është anuluar mbledhja e Këshillit për Legjislacionin sot në mëngjes, e cila duhej të vendoste mënyrën sesi do të procedohej për zgjedhjen dhe votimin e kandidatëve të Gjykatës Kushtetuese?

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Së pari, u nxitove që more fjalën, sepse nuk kemi arritur aty. Pastaj mund ta merrje fjalën për procedurë.

Lidhur me çështjen që trajtuat, me kalimin e kohës do t'u vijë radha dhe do të marrin përgjigje të gjitha shqetësimet e tua, të cilat mund të jenë edhe legjitime, nuk e diskutoj.

Shpeshherë e shfrytëzoni të drejtën tuaj për të marrë fjalën për procedurën, në një kohë kur mendova se kishit probleme me rendin e ditës për të hequr ndonjë pikë. Ju kërkoni sqarime për një nga pikat e rendit të ditës, kur t'i vijë radha asaj sigurisht që ka vend kërkesa juaj, me përmbajtjen që parashtruat në Kuvend.

Përpara keni procesverbalin, ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave në Kuvend është depozituar projektligji “Për buxhetin e shtetit për vitin 2020”, si edhe projektligje të tjera. Nga deputetët është depozituar një propozim për zgjedhjen e një anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

Nga Presidenti i Republikës është depozituar kthimi për rishqyrtim në Kuvend i ligjit nr. 71 i vitit 2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”. Ju njoftoj, gjithashtu, se për dy vakancat në Gjykatën Kushtetuese kam kërkuar të thirret mbledhja e Këshillit për Legjislacionin që të shprehet për kushtetutshmërinë e procedurës së votimit të dy kandidatëve, që të marrin përgjigje të gjitha pyetjet tuaja. Këshilli i Legjislacionit do të mbledhet dhe do të japë mendim lidhur me

kërkesën e bërë, para se të kalojmë në çështjen përkatëse. Prandaj, të thashë që u nxituat.

Listën e njoftimeve e keni të gjithë përpara. Materialet, si gjithmonë, do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Atëherë, vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Ky projektligj, siç e dini, është shqyrtuar me procedurë të përsheptuar.

Ministri, zoti Klosi.

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë, projektligji që paraqitet sot për miratim, pa dyshim e ka të vështirë që të tërheqë vëmendjen e kolegut parafolës, i cili ka shumë më tepër shqetësim Gjykatën Kushtetuese. Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese është shqetësim për një vend, por edhe aderimi në një konventë shkencore duhet të ketë vëmendjen e kolegëve deputetë dhe duhet të ketë kuptim se për çfarë i ndërmarrim veprimet tona. Jemi këtu në këtë parlament të votuar nga qytetarët e thjeshtë si deputetë të Kuvendi të Shqipërisë për të bërë politika, të cilat ofrojnë më shumë mundësi, mirëqenie për vendin tonë dhe krijojnë hapësira të reja për të bërë ekonomi në Shqipëri. Edhe aderimi në Komisionin Ndërkombëtar të Eksplorimit Shkencor të Detit Mesdhe, edhe pse në titullin e tij është vetëm për të qenë pjesë e një grupi shkencor që merret me detin Mesdhe, është një hapësirë e re për të ndërtuar në Shqipëri një filozofi të re: atë të zhvillimit të një dege shumë të rëndësishme të turizmit, që është turizmi blu, i cili ofron për Shqipërinë një hapësirë krejt të re, e cila ka të bëjë me turizmin detar.

Të nderuar miq, jemi sot në kushte shumë të favorshme për të folur për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, jemi në kushte shumë të favorshme për të thënë se politikat e qeverisë së Edi Ramës, ndjekja në detaje e politikave për sektorë të caktuar, të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit shqiptar, na kanë sjellë përfitime të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, jo vetëm kanë rritur numrin e vizitorëve të huaj në vendin tonë, i cili këtë vit shkoi në mbi 6,5 milionë turistë të huaj, por ka rritur të ardhurat në ekonominë e vendit tonë, ka pasur mundësinë të shtojë buxhetet e ekonomisë, së

njerëzve të thjeshtë, atyre familjarëve të thjeshtë, të cilët punojnë për turizmin, kanë hotele, resorte, punishte të vogla, por kanë edhe restorante, të atyre djemve dhe vajzave që shpërndajnë shezlongët, apo shërbejnë si kamerierë nëpër lokale.

Kjo konventë na jep mundësinë që të jemi së bashku me ekspertët më të mirë të fushës në atë sektor që, siç e thashë, është shumë i rëndësishëm për ekonominë shqiptare në debatin shkencor për vlerat e detit Mesdhe. Ne duam shumë të futemi në këtë botë të re të turizmit detar. Para pak ditëve, edhe pse mediet nuk u fokusuan, një lajm shumë i rëndësishëm ishte që nëpërmjet punës së vazhdueshme, të ndihmuar nga forcat e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, pastruam detin shqiptar, jo vetëm në realitet, por edhe me harta, nga qenia e këtij deti pjesë e detit Mesdhe si zonë e minuar. Tashmë në hartat ndërkombëtare deti Mesdhe nuk është më një zonë e rrezikshme dhe pjesa shqiptare e detit Mesdhe, deti Adriatik dhe deti Jon, është e mundur për të ofruar struktura, të cilat duan ta shfrytëzojnë këtë bregdet për më shumë turistë. Ky komitet ka më shumë se sa 110 vjet që diskuton problematikat shkencore, të cilat kanë të bëjnë me detin Mesdhe, që ka ekspertët më të mirë të vendeve aderuese në këtë konventë nga e gjithë zona e Mesdheut, të cilët mblidhen së bashku dhe përcaktojnë se çfarë duhet të zhvillojmë në këtë industri të re për turizmin detar; janë së bashku për të përcaktuar politika ekonomike dhe shkencore që të kemi atë që Ministria e Mjedisit dhe Turizmit përpiqet të realizojë: një ekuilibër të qëndrueshëm ndërmjet zhvillimit intensiv dhe të qëndrueshëm të turizmit me të gjitha mënyrat, edhe në turizmin detar në zonën e detit Mesdhe, por, njëkohësisht, të kemi një ekuilibër të qëndrueshëm edhe në mbrojtjen e vazhdueshme, të qëndrueshme të mjedisit, mbrojtjen e vazhdueshme të detit, mbrojtjen e vazhdueshme të politikave mjedisore që kontrollojnë këto aktivitete turistike në detin Mesdhe. Me aderimin në këtë konventë ne biem dakord të gjithë së bashku që të jemi pjesë e barabartë e diskutimit me vendet që kanë aderuar në të që para 110 vjetësh, vendet themeluese të kësaj konvente si: Franca, Greqia, Italia, Monako, Spanja, Tunizia, Egjipti apo edhe vende që i janë shtuar kësaj konvente në vitet 1966. Ne jemi nga të fundit vende të Mesdheut

që bëhemi pjesë e tryezës shkencore, ku diskutohen problematikat e mbrojtjes së mjedisit, të mbrojtjes së natyrës, të zhvillimit të politikave turistike në mbrojtjen e këtyre fenomeneve natyrore, por, njëkohësisht, ku diskutohen me ekspertët më të mirë të shkencës mjedisore se çfarë duhet të bëjmë që ekonomia e re të zhvillohet.

Për sa i përket vendit tonë ne duam shumë që Shqipëria të hapet në lidhje me turizmin marin, turizmin blu, turizmin detar, të kemi mundësinë që pozicionin tonë fantastik, strategjik që kemi në Mesdhe dhe në gjithë zonën e Adriatikut dhe atë të Jonit ta shfrytëzojmë për më shumë biznes, për më shumë ekonomi, për më shumë industri dhe për këtë arsye me urdhër të Kryeministrit shqiptar, Edi Rama, ne kemi ndërtuar një grup pune, i cili po merret intensivisht me një sërë politikash të reja që duam t'i ndërmarrim në fushën e turizmit blu për ta hapur Shqipërinë si vendi i fundit, fatkeqësisht, në të gjithë zonën e Mesdheut dhe të Jonit për të qenë pjesë e turizmit të marinës dhe të turizmit blu.

Kjo përpjekje e sotme, të nderuar kolegë deputetë, do të na ndihmojë që, përveçse të kemi zhvillim në turizmin detar, në industri, në shërbim, të kuptojmë çfarë duhet të bëjmë ne për ta mbajtur këtë industri; çfarë duhet të bëjmë për ta kontrolluar këtë industri; çfarë lehtësirash fiskale duhet të bëjmë në sistemin tonë legjislativ për të qenë atraktivë në këtë industri; çfarë duhet të bëjmë, nga ana tjetër, për të rritur më shumë investimet në infrastrukturë; çfarë duhet të bëjmë për të vazhduar atë që ka marrë Ministria e Shëndetësisë prej shumë kohësh, sigurimin e shërbimit shëndetësor 24 orë në 24 në zonat ku ne ofrojmë këto shërbime; çfarë duhet të bëjmë për edukimin e mëtejshëm të brezit të ri që të shërbejë në këtë industri të re; çfarë duhet të bëjmë me të gjitha fushat e ekonomisë për të futur në ekonominë familjare shqiptare turizmin detar; pra, çfarë duhet të bëjmë më shumë për të ndërruar gjithë mënyrën se si qeveria jonë mendon, mënyrën se si institucionet mendojnë, mënyrën se si shoqëria jonë e pranon këtë lloj të ri turizmi në kuadër të politikave tona për të qenë të barabartë mes të barabartëve në gjithë zonën e Mesdheut.

Prandaj, në kuadër të politikës së re, të hapjes së Ballkanit si një e tërë për sa u përket

rrymave të ndryshme ekonomike kjo industri do të ndihmojë shumë që Shqipëria, si porta hyrëse në det e gjithë zonës së Ballkanit, të marrë një zhvillim shumë më të madh dhe për këtë ne të gjithë duhet të përgatitemi.

Kjo konventë e re sot na bën bashkë me shkencëtarët e fushës për t'u përgatitur për këtë industri të re, e cila pa i afrohet me shpejtësi bregut shqiptar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Para se të hap diskutimin, lidhur me një sugjerim të drejtë që bëri zoti Gjoni, kur vjen puna të votimet për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ka diskutime apo jo, ka precedent parlamentar apo jo, sa herë parlamenti ka për shqyrtim dhe për votim emra për të gjitha organet kushtetuese, apo me ligj të veçantë, nuk ka diskutime, por ka votime. Ky është rregulli i përgjithshëm sipas Rregullores.

Pashë se ishin regjistruar deputetë dhe, për të mos ua hequr të drejtën e fjalës, do t'ju lutesha që, nëse dëshironi ta marrin fjalën, ta zhvendosin në çështje të tjera që ka seanca e parlamentit, se për këtë çështje ka thjesht votim.

Janë dakord kryetarët e grupeve?

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – I nderuar zoti Kryetar,

Do të kërkoja që ne ta diskutojmë këtë çështje, sepse është një nga çështjet më të rëndësishme që kemi sot dhe ju e dini fare mirë se të dyja listat, që i kanë ardhur Kuvendit të Shqipërisë, janë pak problematike, sepse ne nuk kemi nga të përzgjedhim. Kemi tre emra, dy prej të cilëve janë të përzgjedhur te lista e parë dhe tek e dyta. Automatikisht, në qoftë se te lista e parë zgjedhim atë kandidate, atëherë edhe tek e dyta kemi një kandidate tjetër dhe mbetemi vetëm me dy kandidatë, që janë të imponuar, në fakt, nga këto lista dhe jemi para faktit të kryer. Pra, duhet të gjejmë një zgjidhje. Opozita në Kuvend patjetër që do të gjejë një gjuhë të përbashkët, por, nga ana tjetër, ne nuk mund të thyejmë Rregulloren, ligjin e Gjykatës Kushtetuese dhe procedurën që duhet të ndiqet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ju lutem, nëse është e mundur, në pikat e tjera ne ta trajtojmë këtë çështje, po ashtu edhe në Këshillin e Legjislacionit, ku do të mblidhemi

dhe do të flasim për këtë çështje dhe do të jemi në gjendje të gjejmë një dakordësi.

Unë sugjeroj që të gjitha palët, qoftë edhe Presidenti, të jemi sa më të qetë dhe të tregojmë vullnetin e duhur dhe të gjejmë një gjuhë të përbashkët për ngritjen e Gjykatës Kushtetuese. Gjithkush në këtë sallë, por edhe jashtë kësaj salle, e quan tepër të rëndësishëm ngritjen e GJK-së. Menyra se si do ta ngremë ne këtë gjykatë është përcaktuese për të ardhmen e GJK-së në lidhje me integritetin e saj dhe në asnjë mënyrë ne nuk duhet ta cenojmë integritetin e saj.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Edhe një herë sqaroj se, lidhur me shqetësimin e drejtë që trajton zonja Hajdari, unë kam kërkuar që të thirret Këshilli i Legjislacionit për të dhënë mendim mbi kushtetutshmërinë dhe procedurat e votimit. Ajo që thashë unë është që në Kuvend nuk mund të diskutohet rreth kandidaturave. Kandidaturat janë diskutuar kur ato kanë aplikuar sipas ligjit, janë diskutuar kur janë dëgjuar dhe janë seleksionuar nga Komisioni i Ligjeve, kur kanë aplikuar, janë diskutuar nga organi i emërtesës që në rastin konkret është KED-ja, kështu që Kuvendi nuk ka kompetencën të diskutojë rreth profesionalizmit, performancës e të tjera e të tjera, të kandidatëve, por Kuvendi ka ekskluzivitetin të votojë. Ajo që do të diskutojë Këshilli i Legjislacionit është kushtetutshmëria dhe procedura e votimit, gjë të cilën do ta diskutoni atje. Kjo është ajo që them unë. Dakord? Prandaj, Këshilli i Legjislacionit të gjejë kohën që gjatë zhvillimit të seancës të mblidhet dhe ta shqyrtojë kërkesën që unë i kam bërë, sipas dokumenteve që i kam vënë në dispozicion.

Nisim me diskutimet. Nga Grupi Parlamentar i PS-së janë deputetët: Fadil Nasufi, Besnik Baraj, Ulsi Manja, Alket Hyseni, Etilda Gjonaj, Elisa Spiropali, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Taulant Balla, dhe, në emër të grupit, Andrea Marto.

Nga Grupi Parlamentar Demokrat janë deputetët: Muslim Murrizi, Rudina Hajdari, Korab Lita, Arlind Çaçani, Halil Jakimi dhe Halit Valteri.

Nga Grupi Parlamentar i Pavarur: Enver Rroshi, Ralf Gjoni.

Nga Grupi Parlamentar i Partive të Djathta:
Kostaq Papa, Selami Jenishehri.

Urdhëroni, zoti Nasufi!

Fadil Nasufi – I nderuar zoti Kryetar,

Kolegë deputetë,

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe” është një propozim i Këshillit të Ministrave dhe ratifikimi i tij bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, në kapitullin “Për marrëveshjen ndërkombëtare”.

Në këtë marrëveshje, siç diskutoi edhe ministri Klosi, përfshihen shtetet që lagen nga deti Mesdhe dhe të gjitha vendet që kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në detin Mesdhe. Është kontributi i vendit tonë për mbrojtjen e detit Mesdhe dhe të të gjitha deteve që përfshihen në pellgun e Mesdheut.

Siç tha edhe ministri, ky komision ka një histori gati 110-vjeçare. Ai merret jo vetëm me çështjet e eksplorimit shkencor dhe me të gjitha problematikat e tjera që lidhen me pasurinë ujore. Komisioni drejtohet nga një organizatë ndërqeveritare me seli në Monako. Ai favorizon punimet shkencore, hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qëllime të ngjashme, nxit programe multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar, lehtëson shkëmbimin e informacioneve dhe botimeve në fushën e oqeanografisë, të biologjisë ujore, të gjeologjisë ujore dhe të gjeokimisë. Angazhimi i shteteve pjesëmarrëse në këtë marrëveshje është për një periudhë 5-vjeçare dhe ripërtërihet vazhdimisht me vullnetin e lirë të të gjitha shteteve pjesëmarrëse.

Është për t’u shënuar fakti që është i angazhuar një rrjet i tërë studiuesish nga të gjitha vendet që përfshihen në pellgun e Mesdheut dhe ajo që përfshijmë drejtpërdrejt nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është që Shqipëria përfiton ndihmë teknike dhe financiare me projekte të vogla dhe projekte të mesme.

Komisioni integron një spektër të gjerë të disiplinave detare. Për sa i përket kontributit si një organizatë ndërkombëtare, paguhet një kuotë

rreth 25 mijë euro në vit, e cila nuk përbën problem për çështjet financiare të buxhetit.

Ne jemi të përfshirë në bashkëpunime shkencore ndërkombëtare dhe, pavarësisht se kjo marrëveshje futet sot për t’u nënshkruar në parlament, Shqipëria ka kontribute dhe kapacitete të aderimit dhe të bashkëpunimit në këtë fushë. Siç është bërë e njohur edhe nga Ministria e Mjedisit dhe e Turizmit, ka filluar implementimi i disa projekteve që përfshihen në këtë organizatë ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve në zonat e mbrojtura, si dhe me projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen e monumenteve të natyrës.

Kjo nuk është marrëveshje që ka vetëm Ministrinë e Mjedisit si pjesë të bashkëpunimit dhe të përfaqësimit të qeverisë shqiptare, por nga kjo marrëveshje mund të përfitojnë të gjitha shoqatat, mund të përfitojnë institutet shkencore, mund të përfitojnë universitetet. Ministria e Mjedisit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, i cili ka një eksperiencë modeste në programet që zhvillon për eksplorimin e deteve, ka bashkëpunim me Universitetin e Mjedisit dhe Universitetin Bujqësor, prandaj këto kanë shansin që nëpërmjet kësaj marrëveshjeje të thellojnë bashkëpunimet edhe me shtetet e tjera të përfshira në këtë marrëveshje.

Në pikëpamjen e hapësirës së re të bashkëpunimit që krijohet dhe të dritares që hapet, padyshim që është edhe një shans për integrimin e vendit tonë në organizata, të cilat pasurojnë rrjetin e gjerë bashkëpunues të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, është një mundësi sensibilizimi për ekspertët, por edhe për të gjithë shoqërinë, sepse, pavarësisht se kjo ka natyrë shkencore, ne ende kemi shumë nevojë të përfshihemi në projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, në projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës, në projekte që kanë të bëjnë me përditshmërinë e vendit tonë për të qenë një Shqipëri e pasur, për të pasur dete të pastra, për të pasur qytete të pastra, sepse vazhdimisht na riciklohen problematika që krijojnë imazh jo të mirë në aspektin e mbrojtjes së mjedisit. Kjo gjë krijon një hapësirë më të madhe për më shumë biznes, për më shumë turizëm, për më shumë eksperiencë, që kanë të bëjnë me bashkëpunimin shkencor dhe qarkullimin e vlerave dhe standardeve që kanë

vendet e Mesdheut, në eksplorimin e deteve, por edhe në përfitueshmërinë nga pasuritë ujore që zotërojnë.

Duke e parë jo vetëm në aspektin e një detyrimi kushtetues që ka parlamenti për ta ratifikuar këtë marrëveshje, por edhe si një hapësirë të mundshme bashkëpunimi, zgjerimi, integrimi, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë këtë marrëveshje!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit!

Zoti Murrizi e ka fjalën. Të përgatitet Besnik Baraj.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Së pari, kisha një dy-tri pyetje në lidhje me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Me sa shoh në relacionin shpjegues, propozohet si rrjedhojë e faktit se Shqipëria është një nga shtetet që laget nga deti Mesdhe. Nuk e mbaj mend veten si të mirë në gjeografi, por, me sa di, ne na lagin dy dete: Adriatiku dhe Joni.

Po qesh Ulsiu, se mos ky deti Mesdhe kap ndonjë cep nga Dibra, se nuk e di.

Në qoftë se e keni fjalën për lagie indirekte, ne mund të lagemi edhe nga oqeani Paqësor, oqeani Atlantik, Oqeani i Ngrirë i Veriut, se ujë pas uji e dorë pas dore arrijnë deri te lumenjtë tanë.

E dyta, në sqarimin tuaj thoni se ky projektligj nuk është i parashikuar nga programet e përgjithshme analitike dhe të projekteve për vitin 2019 të miratuar nga qeveria. Çfarë na nxiti për ta bërë?

E treta, shoh të keni thënë se projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit European. Cili është interesi ynë, që e bëjmë?

Në fund thoni se ne do të paguajmë 25 mijë euro si kuotë. Bëhet fjalë për të punësuar një njeri në Monte Carlo, apo i kemi me gjithë mend ato resurse, të cilat ministri i lançoi pak më parë në këtë foltore, që me aderimin dhe miratimin e kësaj konvente, turizmi shkon lumë, shkencëtarët tanë oqeanikë do të bëjnë namin dhe do të bëjmë studimin se përse po deformohet deti Mesdhe nga ngrohja globale.

Ku i kemi këta shkencëtarë? Ne edhe në Akademinë e Shkencave kemi vënë Skënder Gjinushin, ministrin e fundit komunist të Ramiz Alisë. Ku janë këta shkencëtarë që s'i ditkemi?!

Gjithsesi, për të qenë sinkron me listën e parë të regjistruar të kolegëve të majtë, meqë i pashë se ishin regjistruar të gjithë ata të Komisionit të Ligjeve, dhe besoj se brenda Rregullores së re këta do të flasin në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, e jo për aderimin e në konventën e shkencës oqeanike, për të rritur numrin e turistëve në Shqipëri, dy fjalë do të përpiqesha të thosha edhe në lidhje me procedurën që ndiqet. Nuk kemi pse të nxitojmë në Këshillin e Legjislacionit dhe të lëmë seancën, sepse, në qoftë se sot mbledhet edhe Komisioni i Ligjeve, nëntëmbëdhjetë i ka Komisioni i Ligjeve, një trembëdhjetë bëjnë Këshillin e Legjislacionit, nëntëmbëdhjetë Komisioni i Jashtëm, atëherë nuk e di se kush ngelet këtu. Tridhjetë e pesë jemi gjithsej.

Kësisoj, kur e keni pasur me kaq ngut plotësimin e vendeve vakante, gjë që absolutisht e dua edhe unë, por besoj se edhe pjesa tjetër e opozitës dëshiron t'i plotësojë një orë e më parë vendet vakante të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, që të funksionojë edhe SPAK-u edhe BKH-ja, që të shikojmë ca hajdutë prapa hekurave, asnjë të keqe s'ka, ose të dënohen me punë korrektuese dhe të korrin jonxhë në Tërbuf apo të lyejnë kazanët e plehrave si kampioni, absolutisht që nuk jemi kundër as unë personalisht dhe as deputetët e opozitës, por le të zgjedhim, siç thotë Kushtetuta, jo të votojmë. Me të votuar e provuam më 30 qershor.

Tani na sillni tre emra, njëri prej të cilëve është emëruar, kështu që do të zgjedhim një nga ata dy të tjerët. Çfarë do të zgjedhim? Ç'është ky ngut? Shqiptarët kanë një shprehje të urtë popullore: “Më mirë djepi bosh se sa dreqi brenda”. Unë e di se ndodhemi para një fakti të hidhur, se prej gati një viti e gjysmë nuk funksionon as një hallkë e sistemit të drejtësisë, ndaj kërkojmë të fusim dreqin brenda vetëm për të mos lënë djepin bosh, por jo me kaq drita ndezur.

Ç'është ky kryetar KED-i, një ish-prokuror komunist i viteve '88 – '91, një enverist në gen, që, kur ka gjyqe me Metën, voton për të mos hyrë Meta në burg, ndërsa sot bën karshillëk me Presidentin, jo me Metën; në atë kohë e kishte

me Metën, ndërsa sot e ka me Presidentin; nuk pyet për vendimin e KED-it, por i dërgon emrat për t'u votuar në Kuvend në limitet e fundit, me firmën e tij.

Ç'është ky? Pronar i KED-it është ky? Ky, që është ruajtur me vendimin tuaj dhe nga heshtja juaj dhe e atyre që kanë qenë këtu, ka vite që rri aty, ndonëse i ka mbaruar mandati në Gjykatën e Lartë. E keni kthyer në monument kulture dhe e ruani me ligj të veçantë, si Urën e Tabakëve.

Çfarë është ky, more? Në qoftë se e keni marrë parasysh, zgjatini listat. Ju keni sa të doni gjyqtarë e prokurorë. Siç keni mbushur listat me OPGJ, siç po bëni vetingun e famshëm, vini njerëz të tjerë aty. Pse duhet të mbyllet me njëzet? Për çudi, na keni sjellë tre individë, të cilët kanë konkurruar për në Shkollën e Magjistraturës, por asnjëri s'ka fituar.

Këta që nuk fitojnë për magjistratë, janë të mençur për Gjykatë Kushtetuese? Janë praktikë? Kështu duhet për Gjykatën Kushtetuese? Të mos fitosh? Gjyqtarë dhe prokurorë tjerë të zakonshëm që nuk vlerësohen nga KPK-ja, që avash-avash është bërë si "kçk", por edhe KPA-ja, nëpërmjet tri kolonave: pasuri, integritet e performancë profesionale, nuk e kalojnë vetingun. Këta që nuk fitojnë në konkursin e magjistraturës, vijnë dhe duan të bëhen pjesë e kupolës më të madhe të sistemit të drejtësisë në Shqipëri: Gjykatës Kushtetuese. Këtyre do t'u drejtohet Kuvendi, do t'u drejtohet qeveria, do t'u drejtohen individët e interesuar në lidhje me çdo konflikt që do të kenë dhe për çdo ligj që do të shikojnë se bie ndesh me Kushtetutën. Këta do ta interpretojnë.

A duhet ndërtuar Gjykata Kushtetuese? Ta kishit ndërtuar pra. Kokat e ndritura që hartuan dhe duartrokitën me të madhe reformën e famshme në drejtësi, e cila u votua 140 me zero këtu, duhej ta kishin menduar këtë lloj handikapi. Ku di unë cili ka qenë ai Ajnshtajni i drejtësisë. Ulsi, ke qenë ti? Nuk ke qenë. Ke qenë ende i paprovuar në zgjedhjet e Dibrës asokohe dhe partia nuk ka pasur shumë besim.

Prandaj, edhe Këshilli i Legjislacionit, edhe Komisioni i Ligjeve duhet të zbatojnë atë nen që thotë Kushtetuta, jo thirrjen e atij që keni zgjedhur ju nga kjo sallë, që sot jeni prishur për mustaqet e Çelos, gjë e cila është puna juaj.

Pra, për të zgjedhur në një vend sovran Gjykatën Kushtetuese, e cila është hallka e fundit ku gjithsecili dhe çdo organ mund të ankohe për çdo parregullsi që vëren në ligje, nuk është diçka që duhet bërë në këmbë dhe me drita ndezur.

Artën e keni botuar mbrëmë në Fletoren Zyrtare, natën. Më bëhet shumë qejfi që ata të shaptillografit të Fletores Zyrtare punojnë edhe ditën e diel. E keni shpallur të dielën në darkë. Në buxhetin e ardhshëm duhet t'u jepni fond page për orë pune jashtë orarit.

Besnikun e ka firmosur ai, se tha: "Mes katër grave, gjeta një burrë, dhe firmosi burri." Tani çfarë ka ngelur këtu? Elsa Toska. Hyn te gratë apo te burrat? Çfarë do të votojmë ne?

Kësisoj, ashtu sikundër sqaroi edhe Kryetari i Kuvendit, të mblidhet Këshilli i Legjislacionit, edhe Komisioni i Ligjeve, e le t'i shikojnë siç duhet. Celularit të Dvoranit, në mos e paçi në grupin e WhatsApp- it të deputetit, i shkruani: hape edhe një herë këtë garë, bëju thirrje ca... Ose çoja ti, Ulsi, listën, thuaji: "Bjeri ata të tjerët këtu, renditi mirë me pikë", se vetë e ka në dorë ai, jo Komisioni i Venecies. Pse, kush i renditi me pikë këta? Ngrija pikët, thuaji, çoji në 99, 99, si në votimet e kohës së Enverit. Pastaj silli këtu që t'u themi shqiptarëve se kemi zgjedhur ajkën e juristëve në Gjykatën Kushtetuese, po kështu edhe në Gjykatën e Lartë, të paktën me ata tre që na përkasin neve, si Kuvend.

Besoj se në të njëjtën frymë është edhe i zgjedhuri juaj i 2017-ës, Presidenti i Republikës. Edhe ai po përpiket të zgjedhë ajkën e juristëve, dhe është halli i tij që ta ketë këtë Gjykatë Kushtetuese sa më të pavarur, sa më ekselente, sa më funksionale që t'u shërbejë interesave të qytetarëve shqiptarë. Besoj se këtë ka për të bërë edhe me Gjykatën e Lartë.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjala për Besnik Baren. Të përgatitet Enver Roshi.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Pavarësisht se sot po bëhet fakt që të aderojë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, Shqipëria ka marrë pjesë në bashkëpunimet shkencore që në fillimet e viteve '90. Në vitin 1991-1992, kur Shqipëria u bë palë në Konventën e Barcelonës për mbrojtjen e detit

Mesdhe, ka pasur disa institucione shkencore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, pikërisht katedra e kimisë analitike dhe ajo e kimisë organike. Me këtë rast do të doja të sillja në vëmendje dy emra shumë të spikatur në këtë fushë, të cilët kanë luajtur rol bashkëpunimet shkencore, të ndjerin Kostë Koçi dhe profesor Alqi Çullaj.

Këta personalitete arritën të krijojnë një nivel dhe një standard bashkëkohor sa i takon bashkëpunimit me këto institucione ndërkombëtare, të cilat merreshin me monitorimin e detit Mesdhe. Që atëherë, deri në vitin 1992, Shqipëria nuk ka pasur informacion në lidhje me të dhënat mjedisore sa i përket përbërjes së biotës së detit Adriatik dhe detit Jon, të sedimenteve dhe të ujërave detarë.

Pas kësaj, pati një seriozitet të përfshirjes së këtyre institucioneve shkencore universitare, si dhe u plotësua një hendeq i madh që ekzistonte në lidhje me të dhënat.

Sidoqoftë, unë do të thosha se kjo marrëveshje është një mundësi shumë e mirë për ta rritur më tej bashkëpunimin. Ajo që ne paguajmë sot është shumë pak, në raport me atë që i vjen Shqipërisë nga pikëpamja e ekspertizës, nga pikëpamja e bashkëpunimit shkencor, nga pikëpamja e botimeve dhe nga pikëpamja e burimeve financiare.

Në këtë kuadër, unë do të thosha, por dhe do t'i lutesha ministrit të Mjedisit që të ketë vëmendjen, ndonëse kohët e fundit është marrë me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, që të adresojë shumë projekte në drejtim të këtij fakulteti, sepse, fatkeqësisht, nga qeveritë të pas viteve '90, ka pasur një ndërprerje të ndihmës që i jepej universitetit me burime financiare dhe me bazë materiale. Një nga këto është pikërisht përfshirja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në monitorimin e bregdetit shqiptar. Përveç informacionit shumë serioz shkencor, njëkohësisht krijohet edhe mundësia që të merren pajisje të ndryshme.

Ju rikujtoj se pajisja e fundit që ka marrë Fakulteti i Shkencave të Natyrës i takon vitit 2003: absorberi atomik. Në një kohë kur teknikat instrumentale evoluojnë shumë, do të ishte mirë që ky fakultet të përfshihej, të shikohej si një partner serioz për plotësimin e këtyre të dhënave, sepse edhe pas viteve 95-96 është krijuar prapë një gap i mungesës së të dhënave. Në këtë

mënyrë, ne do të mundësojmë jo vetëm të kemi në duart tona informacione serioze, por, njëkohësisht, të mund të krijojmë një burim ekonomik, financiar në lidhje me shkëmbimin e përvojave të vendeve të tjera me Universitetin e Tiranës, i cili realisht ka shumë nevojë për ndihmë dhe projekte të kësaj natyre.

Do të thosha se duhet të bëjmë shumë kujdes, sepse është krijuar një mosbesim i madh ndaj institucioneve shkencore shtetërore. Të mos e kalojmë edhe këtë sektor në sektorin privat, se pastaj ka rrezik pastaj. Unë njoh shumë njerëz që merren me sektorin privat, një pjesë e të cilëve, sipas meje, janë si nata me ditën në krahësim me sektorin shtetëror universitar. Do të thosha se puna shkencore që bëhet në universitet është jashtëzakonisht serioze, është e nivelit bashkëkohor, por sot ka nevojë më shumë se asnjëherë, që ata të ndihmohen me burime të ndryshme financiare e me projekte të kësaj natyre.

Prandaj, unë e mbështes këtë projektligj dhe uroj që të luajë atë rol që parashikohet, që edhe ne të radhitemi me dinjitet përkrah vendeve fqinje që monitorojnë detin Mesdhe në përgjithësi, në veçanti Adriatikut dhe Jonin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Baraj!

Fjala për Enver Roshin. Të përgatitet Kostaq Papa.

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, desha të shprehja mbështetjen time në lidhje me marrëveshjen e detit Mesdhe. Ashtu si dhe parafolësi, jam dakord dhe shpreh bindjen se kërkimi shkencor duhet orientuar nëpër universitete. Kjo sepse universitetet kanë tri elemente shkencore bazë: mësimdhënien, shërbimin, kërkimin shkencor. Nuk duhet që këto resurse që vijnë këtu dhe që krijohen në vend, të dalin jashtë deryve të universitetit. Njëkohësisht, shpreh edhe miratimin tim për këtë marrëveshje. Gjithsesi, ky fjalim është i hapur, kështu që do të doja të përqendrohesha pak tek tematika e sotme, e cila ka të bëjë me zgjedhjen e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Hyrja e re në parlament ka qenë një mision i veçantë për t'i shërbyer vendit dhe reformës në drejtësi. Shqiptarët janë lodhur duke ndenjur para deryve të gjykatave. Shumë institucione mungojnë. Qëllimi ynë, i deputetëve që hymë në muajin mars në Kuvend, ka qenë për të mbështetur

reformën në drejtësi dhe për t'i dhënë vendit institucionet e duhura. Sipas mendimit tim, në këta 30 vjet kemi vuajtur dhe po vuajmë se nuk po krijojmë dot modele. Cili do të jetë modeli i referencës që shqiptarët duhet të marrin në këta 30 vjet? Deri tani kemi krijuar modelin e njerëzve të korrupsionit, të krimit, të shitblerjes së tokave, sorollatjes së njerëzve, por nuk po krijojmë atë model që njerëzit dhe brezat e ardhshëm të thonë që këtë vit pati drejtësi, drejtësia funksionoi, këta u ndëshkuan dhe ne e zgjidhëm problemin tonë, atë që e kemi mangësi, të drejtën për një shtet ligjor.

Vetëm për pronat që nga viti 1991 deri sot janë 8 mijë të vrarë. Pjesa e drejtësisë zë elementin kryesor në problemin e zgjidhjes së pronave. Ky është një problem ligjor që na përket edhe neve këtu, për t'u dhënë njëherë e mirë fund lodhjeve të shqiptarëve në dyert e gjykatave. Toka është ndarë e rindarë, është marrë e rimarrë dhe ka përfunduar në duart e krimit.

Kështu që unë shpreh bindjen se duhet të votohen kandidatët për anëtarë që të plotësohet sa më shpejt Gjykata Kushtetuese, SPAK-u, BKH-ja dhe të marrë njëherë e mirë fund kjo lodhje. Jemi shumë të lodhur. Niveli i stresit në Shqipëri ka arritur majat më të larta. Sikur dikush të bëjë një studim për nivelin e stresit të shqiptarët, me siguri do të marrim pikavarazhin më të lartë në revistat më prestigjioze të botës. Shqiptarët janë të lodhur nga prokurorët dhe gjykatësit, nga "kçk"-ja, "kap çfarë të kapësh" apo "bçb"-ja, "bëj ç'të bësh", apo "mçm"-ja, "merr ça të marrësh", të cilat janë krijuar gjithandej. Kjo histori duhet të marrë fund njëherë e mirë që shqiptarët të qëndrojnë në Shqipëri dhe të japin kontributin e tyre.

Ne sot e kemi në dorë t'u japim mundësi këtyre gjykatësve të punojnë dhe t'i shërbejnë vendit tonë. Ky është mendimi im dhe besoj se edhe shumë deputetë të tjerë të krahut të opozitës janë të këtij mendimi. Ne duhet të ecim para. Pavarësisht nga të gjitha ato që ndodhin, ne duhet t'i shërbejmë vendit, atdheut dhe kombit. Çdo gjë që bëhet, nuk bëhet në interes të deputetit, as të partive, por të kombit. E para Shqipëria, pastaj jemi ne, kjo duhet të jetë platforma që të na orientojë sot dhe në të ardhmen.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjala për zotin Papa. Të përgatitet Ulsi Manja.

Kostaq Papa – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Diskutimi i projektligjit për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Eksplorimit Shkencor të Detit Mesdhe është i vonuar, po ashtu i vonuar është aderimi i Shqipërisë në këtë komision, i ngritur më 4 dhjetor 2009 nga 23 shtete.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë komision vjen si rezultat i lagjes nga deti Mesdhe, deti Jon dhe deti Adriatik. Në detin Mesdhe kryhen studime për ujërat detare, për ndryshimet që po pëson deti si rezultat i ngrohjes globale në sipërfaqen e ujit dhe në thellësinë e tij. Për ndryshimet në biodiversitetin detar kryhen studime gjeofizike, gjeoenergjetike, biologjike, kryhen studime për zonën ekskluzive ekonomike, ku përfshihen studimet strategjike dhe gjeostrategjike edhe për Shqipërinë.

Pra, studimet janë të shumëllojshme dhe me interes studimor, shkencor, hartografik, strategjik, ekonomik, natyror, kulturor dhe trashëgimor. Eksplorimi shkencor i detit Mesdhe për Shqipërinë do të thotë eksplorim edhe i ujërave të deteve Jon dhe Adriatik, gjithashtu, do të thotë mundësi studimi, monitorimi, hartografimi, analizimi të ujërave mesdhetare shqiptare, por edhe mundësi të marrjes dhe dhënies së informacionit shkencor real përmes marrëdhënieve standarde ose konstruktive multilaterale, bilaterale, të garantuara nga marrëveshjet e komisionit. Përmes studimeve të institucioneve ndërkombëtare sigurohen investime ndihmëse dhe financiare e tekniko-shkencore. Nëpërmjet projekteve ndërkombëtare mesdhetare sigurohet një komunikim i pandërprerë mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera mesdhetare, por edhe një komunikim midis institucioneve që merren me ujërat mesdhetare.

Deti Mesdhe, ashtu si edhe deti Jon dhe Adriatik, si pjesë përbërëse të tij, po pësojnë ndryshime në biodiversitetin ujor si rezultat i efekteve klimaterike, ndaj përbën domosdoshmëri eksplorimi shkencor, krijimi i zonave detare të mbrojtura dhe zhvillimi i qëndrueshëm për rajonin mesdhetar. Deti

Mesdhe lag tri kontinente, nga i cili vijnë disa probleme. Për Sirinë, Mesdheu, përbën edhe korridorin kryesor të trafikut të refugjatëve, qenieve njerëzore, armëve dhe drogës, qoftë dhe nga rajonet e luftës në Mesdheun Lindor, si edhe nga veriu i Afrikës, Libia, Maroku drejt Italisë dhe Francës, Maltës dhe Spanjës. Pra, aderimi i Shqipërisë në këtë komision është i rëndësishëm, por Shqipëria është e vonuar në këtë aderim, i cili përbën një bashkëpunim të rëndësishëm rajonal për problemet e zonës detare.

Sigurisht, unë e aprovoj aderimin e Shqipërisë në këtë konventë.

Dua të ndalem në disa probleme shqiptare, që kanë të bëjnë me aspekte të mjedisit detar, të eksplorimit detar turistik, të mjedisit detar në detet Jon dhe Adriatik, nga kepi i Spillesë deri në derdhjen e Bunës dhe nga vija bregdetare në ujërat ndërkombëtare, përballë Italisë, në jug me Greqinë dhe në veri me Malin e Zi. Meqë këtë projektligj e ka hartuar Ministria e Turizmit, them se problemet që do të ngre janë më të rëndësishmet si për turizmin, ashtu edhe për mjedisin. Së pari, dua të tregoj se në materialin që i është paraqitur Kuvendit ka një gabim, këtu paraqitet sikur ky komision ka dy seli, një në Marok dhe një në Montekarlo. Këtë shikojeni dhe korrigjojeni!

Problemi që dua të trajtoj ka të bëjë me ndotjen e vijës bregdetare nga qytetarët tanë me lëndë inerte plastike dhe të tjera. Aty ku ujërat detare takohen me derdhjen e lumenjve ka shumë ndotje dhe situata duhet të përmirësohet në dobi të turizmit dhe eksplorimit detar.

Problemet e tjera të shumta kanë të bëjnë me historikun e eksplorimeve detare shqiptare. Gjatë diktaturës eksplorimi detar ishte fillestar dhe afër bregut. Të huajt vinin në ujërat tona për të kapur ndonjë peshk dhe vështirë të eksploronin, sepse trembeshin nga ndonjë predhë e artilerisë bregdetare. Pas viteve '90, duke qenë se Shqipëria hyri në tranzicionin e vështirë me deficienca të mëdha financiare apo mjetesh për eksplorim, ujërat detare gjithmonë e më shumë vizitoheshin për turizëm dhe eksplorim detar nga shumë anije eksploruese të shteteve të ndryshme me interesa të ndryshme. Në përgjithësi vizitorët, eksploruesit, arkeologët, fileologët detarë, edhe kur merrnin leje eksplorimi, kanë abuzuar me pasuritë tona nënujore detare, me gjallesat, objektet arkeologjike detare ose edhe objektet e

fundosura në ujërat tona gjatë shekujve, sepse në ujërat detare shqiptare që nga lashtësia ka plot anije të mbytura me sende të ndryshme.

Gjithashtu, ujërat tona detare kanë nevojë për përpilim hartografik të siteve arkeologjike nën ujë. Po ashtu fauna dhe flora e ujërave detare është e pasur. Nga individë keqdashës ka pasur dëmtim të pasurisë sonë nënujore detare dhe ujërat tona përbëjnë lakmi si rezultat i moseksplorimit për shumë kohë.

Rregullimet e brendshme ligjore duhet të kufizojnë konfuzionin dhe papërgjegjshmërinë e disa shtetasve shqiptarë ose të huaj që vënë dorë mbi sendet, gjallesat e ujërave detare shqiptare.

Aderimi i Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe do të përmirësojë më mirë rregullat për eksplorimin e ujërave detare dhe pasurinë nënujore detare të Shqipërisë duke shtuar turizmin eksplorues detar dhe bashkëpunimin rajonal në shkëmbimin e informacionit shkencor për detin dhe pasurinë detare, sidomos për pasuritë energjetike, për shelfin tonë kontinental të zonës ekskluzive ekonomike.

Meqë jemi në kuadrin e marrëveshjes dhe flasim për aderimin e Shqipërisë, do të doja të tërhiqja vëmendjen dhe të ndalesha pak në një marrëveshje tjetër dhe një zhurmë që është bërë këto ditë në lidhje me minishengenin ballkanik. Doja të ndalesha këtu sepse, nëse kjo lëvizje shihet si iniciativë private e kryeministrit, deputetët shqiptarë duhet të mbajnë qëndrim të caktuar, që ka lidhje me çështjen kombëtare, sepse ky minishengen ballkanik i një Jugosllavie të vogël prek interesat kombëtare, cenon çështjen e Kosovës, njohjen e mëtejshme të saj, anashkalon politikën zyrtare të Kosovës dhe ndikon keq në çështjen globale kombëtare shqiptare.

Kështu që politika në Tiranë, sidomos qeveria shqiptare, nuk mundet të anashkalojë politikanët kryesorë të Prishtinës, sepse Republika e Kosovës tashmë është një shtet i njohur nga rreth 115 vende, të cilët kanë përfaqësuesit e tyre ligjorë, zyrtarë, politikë dhe mbajnë përgjegjësi për popullin e Kosovës për çështjen tonë kombëtare. Kështu që më mirë do të ishte që Kryeministri shqiptar të kishte ofruar një minishengen tjetër të shqiptarëve midis Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Malit të

Zi, ku pjesa përbërëse themelore në këto shtete, ashtu si në të gjithë Ballkanin, janë shqiptarët dhe themeli i saj është çështja kombëtare shqiptare.

Gramoz Ruçi – Fjala për Ulsi Manjën. Të përgatitet Korab Lita.

Ulsi Manja – Të nderuar kolegë deputetë, nuk do të flas për konventën, sepse për rëndësinë shkencore dhe qëllimin e aderimit të Shqipërisë në këtë konventë foli ministri Klosi, ndërsa kolegët e mi deputetë folën në mënyrë shteruese për konventën.

Kuvendi i Shqipërisë sot ka në rendin e ditës edhe plotësimin e dy vakancave për Gjykatën Kushtetuese që i takojnë Kuvendit.

Sot është momenti të tregojmë të gjithë seriozitetin dhe vullnetin politik për ta bërë sa më shpejt funksionale Gjykatën Kushtetuese jo vetëm si domosdoshmëri kombëtare për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe të sistemit tonë politik dhe kushtetues, por edhe si një plotësim i një prej detyrave tona në prag të çeljes së negociatave me Bashkimin Europian.

Si ligjvënës ne sot duhet të bëjmë detyrën tonë duke mbështetur me votë kandidatët që na ofrohen për votim dhe që për fat të mirë janë dy zonja, që në vlerësimin tim personal, por edhe si kryetar i Komisionit të Ligjeve, i bëjnë nder Gjykatës Kushtetuese.

Kemi një debat me Presidentin e Republikës në këtë fazë të procesit të plotësimit të vakancave në Gjykatën Kushtetuese. Po, e kemi. Si përherë na paraqitet si debat kushtetues dhe ligjor, por në thelb është një konflikt i pastër politik dhe institucional, qëkur Presidenti i Republikës e lexon Kushtetutën politikisht kur, në fakt, do të duhej të ishte garant i saj.

Kur flitet për Gjykatën Kushtetuese, Presidenti duhet të ishte personi i parë i interesuar që ajo të jetë një orë e më parë funksionale, sepse është aleatja e tij kryesore në garantimin e zbatimit të Kushtetutës, si gur i themelit të Republikës sonë parlamentare për të cilën ai është betuar.

Në rastin e Gjykatës Kushtetuese Presidenti duhet të çlirohet nga mentaliteti i konfliktit politik dhe duhet të punojë ngushtësisht me Kuvendin dhe Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të plotësuar sa më parë edhe dy vakancat e tjera, që janë në procedurë e sipër në Këshillin e Emërimeve në

Drejtësi, si tregues i luajalitetit dhe bashkëpunimit kushtetues.

Çfarë thotë Kushtetuta për përbërjen e Gjykatës Kushtetuese dhe si plotësohen vendet në Gjykatën Kushtetuese? Gjykata Kushtetuese, të nderuar kolegë, përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 9- vjeçar pa të drejtë rimerimi. 1/3-ës së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që do të thotë 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, iu ripërtërihet mandati çdo tre vjet. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sipas ligjit.

Cilat janë organet e përfshira në kompozimin e Gjykatës Kushtetuese? 3 anëtarë i emëron Presidenti, 3 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe 3 anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Këto thotë neni 125 i Kushtetutës dhe ligji organik për Gjykatën Kushtetuese, i ndryshuar në vitin 2016 në kuadrin e reformës në drejtësi.

Çfarë ndodh në rast se Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës dhe Gjykata e Lartë nuk e ushtrojnë këtë kompetencë kushtetuese sipas ligjit? Kushtetuta flet shumë qartë. Në rast se Kuvendi brenda 30 ditëve nga momenti që ka marrë listat nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk e ushtron pretendencën kushtetuese për të zgjedhur njërin nga tre kandidatët që janë në listë. Kandidati i renditur i pari në listën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi automatikisht konsiderohet i zgjedhur. Të njëjtin përcaktim, ligji organik për Gjykatën Kushtetuese e ka bërë edhe për Presidentin e Republikës dhe për Gjykatën e Lartë. Në ligj thuhet: “Në rast se Presidenti brenda 30 ditëve nga momenti që ka marrë në dorëzim listat nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për vakancat që i takojnë Presidentit të Republikës nuk e ushtron këtë të drejtë kandidati i renditur në listë i pari konsiderohet i emëruar”.

Rezulton se Presidenti i Republikës i ka marrë listat nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mos gaboj, në datën 8 tetor 2019, dy lista. Në njërin ka tre kandidatë për vakancën e datës 07.02.2018 dhe në listën e dytë, që i takon vakancës së datës 04.03.2019, ka marrë një listë me 4 kandidatë. Sipas përcaktimit të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, deri në datën 7 nëntor në orën 12:00 të natës Presidenti i

Republikës do të duhet të ushtrojë të drejtën kushtetuese për të dekretuar emërimin e dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. E ka bërë për vakancën e datës 07.02.2018, duke dekretuar zotin Besnik Muçi, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, i cili tashmë është anëtar i kësaj gjykate. Për anëtarin e dytë Presidenti i Republikës, çuditërisht, në datën 5 nëntor 2019 i dërgon një letër Kryetarit të Kuvendit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku thotë: “Unë po vetëngrij, po ngrij edhe Kushtetutën dhe do ta bëj dekretimin e anëtarit të dytë, pasi Kuvendi të bëjë plotësimin e vakancës së dytë që i takon Kuvendit, sepse, thotë Presidenti, radha e përcaktuar në nenin 179, pika 2 të Kushtetutës është, të parin e zgjedh Presidenti, të dytin Kuvendi dhe të tretin Gjykata e Lartë”.

Po, është e vërtetë që Kushtetuta e ka bërë këtë radhë, por Kushtetuta radhën e ka përcaktuar për të shmangur konfliktin institucional mes tre organeve që përfshihen në kompozimin e Gjykatës Kushtetuese, sepse 1/3 e anëtarëve, 3 anëtarë, përtërihen çdo tre vjet, por radha përcakton kompetencën se kush e ka radhën, por nuk përcakton veprimin kohor se cili organ vepron i pari, cili i dytë dhe cili i tretë. Në procesin e kompozimit të Gjykatës Kushtetuese secili nga organet që përfshihet në këtë proces, Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, e ushtron këtë kompetencë kushtetuese në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. I vetmi kufizim kohor që ka Kushtetuta dhe ligji është afati 30-ditor dhe ky afat, të nderuar kolegë, është afat prekluziv, që do të thotë se as nuk mund të ndërpritet, as nuk mund të pezullohet dhe as nuk mund të zgjatet, ndryshe vjen pasoja, sipas Kushtetutës dhe ligjit, kandidati konsiderohet i emëruar ose i zgjedhur.

Radha, të nderuar kolegë, është përcaktuar edhe për një arsye tjetër, ka pasur në konsideratë përtëritjen normale të Gjykatës Kushtetuese. A jemi ne një situatë normale të përtëritjes së Gjykatës Kushtetuese? Jo, sepse vetingu e spastroi Gjykatën Kushtetuese dhe u krijuan pothuajse gati 9 vakanca përnjëherë, vetëm një nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese u konfirmua në detyrë nga vetingu.

Çfarë ndodh? Kemi Gjykatën e Lartë, një organ kushtetues i përfshirë në kompozimin e Gjykatës Kushtetuese. Kam një pyetje për juristët e Presidentit, por edhe për Presidentin e

Republikës, pavarësisht se nuk është jurist dhe nuk e ka domosdoshmëri të jetë jurist. E supozojmë se do të zbatojmë radhën, të parin e ka dekretuar Presidenti, të dytin po e votojmë ne sot, por radha nuk i shkon Presidentit, sipas nenit 179/2 të Kushtetutës, radha i shkon Gjykatës së Lartë. Në Gjykatën e Lartë momentalisht nuk e kemi funksionale. Atëherë, çfarë do të bëjmë sipas Presidentit të Republikës, do ta bllokojmë Gjykatën Kushtetuese edhe për një vit tjetër?

Ja pra, arsyetimi i Presidentit nuk është qëllimshëm, është dashakeq, sepse me këtë mënyrë interpretimi të normës kushtetuese as më shumë dhe as më pak synohet bllokimi i bërjes funksionale të Gjykatës Kushtetuese.

Ndaj, të nderuar kolegë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, që njëjloj si Presidenti i ka marrë listat në datën 14 tetor 2019 brenda datës 13 nëntor, e cila është pas dy ditësh, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të ushtrojë kompetencën për të zgjedhur dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që i takojnë Kuvendit të Shqipërisë dhe këtë të drejtë Kuvendi e ushtron sot me votimin që do të kryhet pak më vonë fiks brenda afatit 30-ditor, që e kondicionin Kushtetuta dhe ligji organik i Gjykatës së Lartë.

Kuvendi ka vullnetin e mirë për të bashkëpunuar me të gjitha organet e tjera kushtetuese, që Kushtetuta dhe ligji i ka bërë pjesë të kompozimit të Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë rast ftoj Presidentin e Republikës, pse jo Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, që të bëhemi pjesë konstruktive e këtij procesi dhe e zhbllokimit të situatës në Gjykatën Kushtetuese.

Ndërsa, sa u takon kolegëve të mi deputetë në këtë sallë është momenti që sot të dëshmojmë vullnetin tonë politik se shqetësimin e madh që kemi për të pasur një orë e më parë funksionale Gjykatën Kushtetuese, por edhe të plotësojmë një nga detyrat që kemi në prag të çeljes së negociatave. Është momenti që këto dy zonja që ne do të votojmë pak më vonë, pse jo, nëse do të jenë prezentë në sallë 121 deputetë, t'i mbështesim me votë, sepse...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Manja!

Fjalën e ka Korab Lita,

Të përgatitet Etilda Gjonaj.

Korab Lita – Faleminderit, zoti Kryetar!

Si sot 7 muaj me parë jam betuar në këtë sallë për të përfaqësuar komunitetin dhe votuesit e mi. Nuk ishte aspak e lehtë për të vendosur

nëse do ta pranoja mandatin e deputetit apo jo pas ngjarjeve politike që rodhën.

7 muaj më pas mendoj se e kam bërë zgjedhjen e duhur dhe gjithmonë e më shumë jam i bindur për këtë gjë, për një arsye shumë të thjeshtë, nuk desha ta lija atë komunitet pa një zë në institucionet e Republikës së Shqipërisë, për të gjitha sfidat historike që ka vendi ynë përpara. Jam munduar që këto 7 muaj të kem vetëm një qëllim, të diskutoj, të ngre çështje dhe të votoj vetëm në të mirë të shqiptarëve dhe të së ardhmes së tyre.

Vendi ka përpara sfida të rëndësishme dhe historike si procesi i integrimit evropian, reforma në drejtësi, reforma zgjedhore, të cilat për fajin e politikës 30-vjeçare janë vonuar më shumë sesa duhet dhe këto vonesa po kthehen në një kosto të madhe shoqërore, politike dhe ekonomike për Shqipërinë dhe për shqiptarët. Çdo ditë që kalon për zbatimin e reformës në drejtësi është në dëm të Shqipërisë dhe në këtë kuptim nuk duhet humbur asnjë ditë më shumë për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë.

Shqipëria në këtë moment që jemi duke folur ka një emergjencë kombëtare. Praktikisht jemi pa pushtet gjyqësor ose me një pushtet gjyqësor gjysmak dhe në shumë pjesë të tij të korruptuar. Një gjendje, e cila në fakt ka 30 vjet që është kështu, pasi ju e katandisët drejtësinë si një vegël tuajën për të vjedhur Shqipërinë dhe për të varfëruar shqiptarët. Prandaj, edhe në këto vite keni bërë çmos për ta penguar reformën në drejtësi, sepse është në kundërshtim me filozofinë tuaj të "KÇK"-së. Ju jeni grupi kryesor i kap ç'a të kapësh. Ata që ju i quani të tillë sot janë emëruar prej jush, ata kanë qenë bashkëpunëtorët tuaj për 30 vjet. Mirëpo, shumë shpejt të gjithë do të përfundoni duke u dhënë llogari shqiptarëve, për atë çka ju keni bërë në këto 30 vjet. Dita e gjykimit po vjen për ju dhe kjo gjë jua ka prishur gjumin, prandaj deri më tani keni përdorur çdo lloj makinacioni për t'i vënë shkopin në rrota organeve të reja të drejtësisë.

Që në fjalën time të parë në këtë foltore deklarova se do ta bashkoj votën time me maxhorancën për miratimin e paketës së reformës në drejtësi, për miratimin e të gjitha akteve ligjore që kanë të bëjnë me proceset integruese të vendit tonë dhe për një reforme zgjedhore që garanton votën e lirë dhe garën e

hapur demokratike. Këto kanë qenë disa nga arsyet kryesore se përse e pranova mandatin e deputetit.

Atëherë, mora shumë kritika nga demokratët, elektorat nga i cili vij, dikush më thoshte se jam shitur, dikush se po ndihmoj maxhorancën, dikush se u bëra socialist. Në fakt, edhe ata që më kritikuan do ta kuptojnë shumë shpejt se vota ime dhe e grupit tonë rezultoi si mekanizmi kryesor i zhbllokimit dhe ecjes përpara të reformës në drejtësi, reformës zgjedhore dhe të proceseve integruese.

Gatishmëria e deputeteve të opozitës për të votuar këto tri çështje të rëndësishme për vendin e gjeti të papërgatitur maxhorancën qeverisëse. Nuk ka si të shpjegohet ndryshe se pse po vonohen në rrugën e tyre këto 3 procese. Votimi në Kuvend i ligjeve të reformës në drejtësi është mbyllur që në sesionin e kaluar, pra që në muajin korrik. Sot, jemi në mes të nëntorit, kanë kaluar 4 muaj dhe kemi dy kandidatët e parë për votim për Gjykatën Kushtetuese.

Po me Gjykatën e Lartë çfarë po bëhet? Po me SPAK-un çfarë po bëhet? Po me Byronë Kombëtare të Hetimit çfarë po bëhet?

Çdokush e kupton se po përdoren lloj-lloj mekanizmash bllokues për ta kamufluar dhe për ta zvarritur sa më shumë këtë proces. Dikush mund të pyesë se pse po ndodh kjo? Përgjigjja është shumë e thjeshtë, shumica e kësaj klase politike do të jenë objekt i punës së këtyre strukturave. Ata që e katandisën drejtësinë në këtë gjendje nuk mund të jenë ata që bëjnë drejtësi në këtë vend. Mendësia që i sjell probleme një shoqërie, e cila është mendësia juaj 30-vjeçare, nuk mund të jetë ajo që i zgjidh këto probleme.

Prandaj i vetmi falënderim nga kjo foltore u takon partnerëve ndërkombëtarë të përfshirë në këtë proces, por në mënyrë të veçantë qeverisë amerikane për ndihmën e madhe që kanë dhënë për këtë proces, pa të cilën ne nuk do të kishim kurrë një reformë në drejtësi.

Nga ana tjetër në emër të qytetarëve shqiptarë dua të kërkoj vëmendjen e veçantë të tyre për ta përmbyllur këtë proces kaq të rëndësishëm për vendin tonë, madje u bëj thirrje që ta monitorojnë me kujdes të veçantë fazën e fundit të zbatimit të reformës në drejtësi, sepse qeveria shqiptare, e cila është subjekt i kësaj reforme po përdor të gjitha instrumentet e saj të

pushtetit për të pasur akses në organet e reja të drejtësisë.

Të nderuar partnerë,

Në çdo moment që ndihmoni për reformën në drejtësi, ju duhet ta dini se nuk po ndihmoni klasën politike, por po ndihmoni qytetarët shqiptarë, qytetarët më të vuajtur të Europës. Pas 30 vjetësh agjenda e klasës politike është e ndryshme me atë të qytetarëve shqiptarë. E them këtë për te paktën 3 arsye.

Prej 30 vjetësh me këtë klasë politike nuk po arrijmë të bëhemi dot anëtarë të Bashkimit Europian. Ka plot vende të ish-bllokut komunist që janë bërë anëtarë prej vitesh. Çfarë ka mangët Shqipëria?! Përgjigjja është shumë e thjeshtë, janë vetë politikanët që nuk e duan integrimin dhe e pengojnë atë. E para.

E dyta, prej 30 vjetësh e njëjta klasë politike nuk bën dot një palë zgjedhje me standarde, një reformë zgjedhore që t'i rezistojë kohës, pasi ata në çdo zgjedhje bëjnë arime të ligjit zgjedhor në funksion të pazarit të radhës.

Ata e dinë se po të votohet lirshëm dhe po të numërohen votat drejtë, kjo klasë politike do të shkërmoqet.

E treta, prej 5 vjetësh që ka filluar reforma në drejtësi me ndihmën, këmbënguljen dhe shpeshherë edhe me detyrim nga ndërkombëtarët, prapë ia kanë arritur ta zvarrisin në kohë. Pse behet kjo? Për të zgjatur jetën e tyre politike.

Dita e sotme qoftë një ogur i mirë për ripërtëritjen e shtetit, i cili aktualisht nuk ekziston në të gjithë komponentët e tij, por është bërë njësh me pushtetin. Unë, si përfaqësues i qytetarëve sot ndihem mirë, pasi vota ime dhe e kolegëve të mi opozitarë po jep frytet e para.

Dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese i inkurajoj të jenë jashtë çdo ndikimi politik, të jenë gardianë të Kushtetutës dhe të kthejnë besimin e qytetarëve te ligji dhe te drejtësia.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka Etilda Gjonaj.

Të përgatitet Ralf Gjoni.

Etilda Gjonaj - I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot po përmbyllim një ndër proceset më të rëndësishme për ngritjen dhe funksionimin e

Gjykatës Kushtetuese, proces, i cili konkludohet me votimin e dy anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi, ndërmjet kandidatëve më të mirë që kanë kaluar një proces verifikimi të figurës dhe pasurisë dhe janë renditur në bazë të aftësive dhe meritave të tyre nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese ka qenë pa dyshim një ndër çështjet më shqetësuese për të gjithë, duke e konsideruar si një ndër institucionet kyçe që luan një rol themelor në garantimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, në përcaktimin e roleve të të gjitha organeve kushtetuese, si dhe në funksionimin e vetë demokracisë së një vendi.

Ngritja dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese është një rekomandim dhe një shqetësim i të gjitha vendeve të Bashkimit Europian, duke përbërë kështu thelbin dhe një ndër kushtet për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Për këto arsye procesi i emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese përbën një domosdoshmëri dhe duhet të jetë prioritet mbi çdo prioritet i të gjitha institucioneve, të cilat duhet të veprojnë me përgjegjshmëri maksimale në ushtrimin e detyrave kushtetuese.

Me reformën e re në drejtësi ne lamë pas një model, ku emërimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese realizohej nga ndërveprimi i Presidenti me Kuvendin, ku mungesa e profesionalizmit, por dhe ndikimi politik në Gjykatën Kushtetuese ishte tejet i lartë. Tashmë, me sistemin dhe formulën e re të zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ulët ndjeshëm ndikimi politik në zgjedhjen e anëtarëve, si dhe garantohet merita profesionale dhe integriteti i kandidatëve të paraqitur pranë organeve të emërtesës si Kuvendi dhe Presidenti, nga një organ i parashikuar në Kushtetutë, siç është KED-ja.

KED-ja ka kryer një proces të gjatë verifikimi dhe vlerësimi, duke i paraqitur listën me kandidatët më të mirë (sipas renditjes së pikëve), si Presidentit, ashtu dhe Kuvendit. Për fat të keq, edhe ky proces, si çdo proces tjetër i reformës në drejtësi, po shndërrohet në një instrument për të luftuar reformën në drejtësi dhe për të penguar ngritjen e Gjykatës Kushtetuese.

Sot gjendemi në një debat publik mes Presidentit dhe KED-së, i cili, më shumë se sa një debat ligjor dhe kushtetues, është një debat

politik. Presidenti i Republikës, pasi plotësoi një ndër vakancat e shpallura si organ emërtese, duke zgjedhur mbi listën e KED-së dhe duke emëruar vetëm Besnik Muçin, për vakancën e dytë, nuk e ushtroi përgjegjësinë e tij për të zgjedhur kandidaturën për në Gjykatën Kushtetuese, por, duke mbajtur në konsideratë problemet e së kaluarës, ku debati mes Presidentit dhe Kuvendit për kandidaturat shtyhej me muaj dhe vite sepse nuk kishte një kompromis, mekanizmi zhblllokues i parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj është zgjidhja më e mirë për të shmangur bllokimet e së kaluarës për zgjedhjen e anëtarëve.

Por çfarë thotë Kushtetuta për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese? Ose ai zgjidhet apo emërohet brenda afatit prekluziv kushtetues 30-ditor nga organi i emërtesës, ose, në raste të mospërzgjedhjes apo mosemërimit, kandidati i renditur i pari pas këtij afati shpallet automatikisht i emëruar. Mungesa e shprehjes së vullnetit të Presidentit për vakancën e dytë shpall automatikisht anëtar të Gjykatës Kushtetuese të parin të renditur nga lista e KED-së, duke emëruar automatikisht anëtarë të Gjykatës Kushtetuese zonzjën Arta Vorpsi.

Asnjë mjet tjetër nuk mund ta zhbëjë këtë parashikim kushtetues, as me dekrete presidenti e as me letra, në të cilat kërkohet pezullimi i një afati, që jo më kot Kushtetuta e ka parashikuar si të pandryshueshëm, të papezullueshëm dhe pa asnjë mundësi për ta shtyrë. Nëse çdo organi emërtese do t'i lihej mundësia për të bërë ndryshime, atëherë mekanizmi zhblllokues do të ishte nulitet. Por Kushtetuta i ka thënë qartazi mënyrën e përzgjedhjes dhe afatet për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe askush, duke përfshirë edhe Presidentin, nuk mund ta shkelë ato.

Presidenti i Republikës ka gabuar me shkresën që i dërgoi KED-së për të pezulluar afatin, duke paraqitur argumente tërësisht antikushtetuese dhe të pabazuara në ligj mbi një afat kushtetues 30-ditor të panegociueshëm, por të detyrueshëm për zbatim nga të gjithë. Presidenti do të gabojë rëndë nëse do të marrë një vendim tjetër të ndryshëm nga ai që ka vendosur Kushtetuta lidhur me vakancën e dytë të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Të gjithë ne, betimin për ushtrimin me përgjegjshmëri të detyrës sonë, e kemi kryer me dorë mbi Kushtetutë dhe ky dokument themelor

duhet të respektohet dhe të zbatohet deri në fund të detyrës sonë, me përgjegjshmëri maksimale. Askush nuk mund t'i ndalojë, apo t'i privojë një shteti dhe shtetasve të tij pasjen funksionale të Gjykatës Kushtetuese dhe ne sot jemi në momentin më të rëndësishëm historik të ngritjes së Gjykatës Kushtetuese. Tashmë është radha e Kuvendit të vendosë me shumicën e kërkuar nga Kushtetuta brenda këtij afati ligjor 30-ditor për zgjedhjen e një prej anëtarëve nga lista e kandidatëve dhe me këto dy vendime të sotme të Kuvendit, bashkë me zonzjën Vorpsi të emëruar automatikisht, numri i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese arrin në 5 anëtarë, duke krijuar kështu premisat për funksionimin e plotë të kësaj gjykate brenda pak javësh.

Unë, përtej diskutimeve që bëhen në këtë sallë, por edhe në medie, jam e bindur se zonzja Vorpsi, e zgjedhur automatikisht, dhe anëtarët e reja, që do t'i shtohen kësaj gjykate, do të jenë një vlerë e shtuar për Gjykatën Kushtetuese, duke rritur profesionalizmin dhe integritetin e anëtarëve të saj. Prandaj ftoj të gjithë deputetët që t'i votojnë kandidaturat për dy vakancat e Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që ta bëjmë funksionale një orë e më parë këtë Gjykatë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala është për Ralf Gjonin. Të përgatitet Elisa Spiropali.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë, duhet të kemi shumë kujdes se si zhvillohet votimi sot në parlament! Të gjithë kemi një përgjegjësi kombëtare dhe historike, sepse jemi përballë një procesi kushtetues me përmasa historike për të mbushur vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese. Kjo gjykatë është një institucion thelbësor në një shtet të së drejtës dhe është kyç për funksionimin e demokracisë dhe të arkitekturës institucionale për të shmangur çdo lloj përplasjeje. Pra, jemi përballë një procesi kushtetues që, për mendimin tim, siç po tregojnë edhe faktet, është ende i paqartë se si po aplikohet.

Të nderuar kolegë, unë mendoj se ne kemi detyrimin t'u përmbahemi Kushtetutës dhe procedurave të parashikuara nga ligji për Gjykatën Kushtetuese. Pyetjet që kam dhe që besoj se i kanë shumë kolegë nga të dyja anët, është si po e zbaton parlamenti Kushtetutën dhe si po e aplikon ligjin? Zoti Kryetar, kush e vendos metodologjinë e procesit, përmes së cilit

do të zgjidhen anëtarët e reja të Gjykatës Kushtetuese? A mos vallë jemi pranë një limiti kushtetues dhe po veprojmë brenda një vakuumi ligjor dhe kushtetues, i cili mund të rezultojë në një furtunë kushtetuese në të ardhmen?

Mënyra si po bëhet procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese më kthen disa vite pas, kur unë kam pasur akses në takimet e para të fillesave të reformës në drejtësi, si dhe në takimet e para me Komisionin e Venecies.

Zoti Kryetar, Komisioni i Venecies që në takimin e parë që ka bërë me Kryetarin e Kuvendit të asaj kohe, pa filluar ende reforma në drejtësi, ka ngritur rëndësinë e moskrijimit të një vakuumi institucional, i cili do të rezultonte në vrima të zeza dhe në institucione jofunksionale. Këshilla e Komisionit të Venecies u injorua në takime të brendshme. Po, po, kolegë, se disa prej jush po hapin sytë se për çfarë po flas. E vërteta është se u hartua një draft i reformës në drejtësi me një arkitekturë institucionale dhe sot jemi para fakteve të pakontestueshme. Shqipëria nuk ka Gjykatë Kushtetuese, nuk ka Gjykatë të Lartë. SPAK-u, BKH-ja dhe institucionet e tjera ende nuk janë ngritur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant, të lutem, nuk je në gjendje të më japësh këshilla për reformën në drejtësi, sinqerisht, sepse këtu po flasim për një proces kushtetues, jo për një proces *whatsapp*-ist socialist për të kapur peng institucionet! Më lër të mbaroj argumentimin tim!

T'i rikthehem ligjit!

Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Dua të lexoj pak nenin 7/c të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. E kemi të qartë që Kushtetuta është shumë e prerë se si përzgjidhen kandidatët, pra, një Presidenti, një Kuvendi dhe një Gjykata e Lartë. Në mungesë të Gjykatës së Lartë, për të mirën e punës dhe për hir të momentit kyç, ku ndodhet vendi, në këtë vakuum institucional, patjetër që mendoj se ka vend për interpretim se si duhet të procedojmë, një Presidenti, një Kuvendi, apo dy Presidenti, apo dy Kuvendi. Kjo nuk më takon mua ta zgjidh, por ekspertëve konstitucionalistë, për ta sqaruar, me qëllim që, ne si deputetë këtu, të votojmë brenda një kornize procedurale të pakontestueshme nesër apo pasnesër, me qëllim

që kandidatët, të cilët do të hyjnë në Gjykatën Kushtetuese, të fillojnë menjëherë nga puna dhe të merren në shqyrtim shumë çështje të rëndësishme me të cilat do të përballlet Gjykata Kushtetuese në muajt në vazhdim. Neni 7/c i ligjit për Gjykatën Kushtetuese është draftuar me ekspertë të EURALIUS-it dhe në kuadër të reformës në drejtësi para disa viteve, in cili është votuar këtu me 140 firma dhe në prani të dy personave atje lart që përqafoheshin.

Personalisht më ka ardhur turp për atë votim, sepse është bërë një votim për ligje dhe për një reformë në drejtësi pa asnjë lloj debati se çfarë po miratonim këtu dhe se ku po shkonim me këtë arkitekturë ligjore që po hartonim këtu në parlament. Dhe ja ku jemi, të nderuar kolegë, përballë faktit ku ligji, në gjykimin tim personal, ka pasur problematika dhe mungesa të theksuara ekspertize në mënyrën se si është hartuar, se nuk janë parashikuar disa gjëra kyçe për sa u përket institucioneve të drejtësisë.

Së pari, nuk është parashikuar se çfarë do të bëhej me vakuumin institucional, nuk u garantua që në draftim vazhdimësia institucionale e Republikës së Shqipërisë. Nuk kishin pse të binin institucionet kushtetuese, si Gjykata Kushtetuese apo Gjykata e Lartë, ndërsa fillonte vetingu i kandidatëve, duke e ditur shumë mirë se shumë prej kandidatëve do të dilnin jashtë loje nga ai veting. Prandaj gjendemi këtu prej muajsh, nuk e di sa kohë u bë, pa Gjykatë Kushtetuese, që është thelbësore për një shtet të së drejtës.

Po lexoj nenin 7/c.

“Kuvendi, brenda 30 ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën e kandidatëve. Brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, Kryetari i Këshillit Emërimeve në Drejtësi thërret mbledhjen e Këshillit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve harton një listë përfundimtare” dhe vijmë te Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, që sipas renditjes, brenda një afati të arsyeshëm, organizon seancat dëgjimore me kandidatët dhe institucionet publike që kanë lidhje me institucionin e drejtësisë, si organizatat e shoqërisë me veprimtarinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e

interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë, mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë KED-it.”

Ne kemi pasur një shkëmbim opinionesh në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, ku kanë kaluar tri kandidatura. Disa kolegë socialistë më paragjyquan se bëra disa pyetje që lidheshin me integritetin profesional të kandidatëve.

E them për sqarim edhe për qytetarët: pyetjet i bëra sepse besoj se një deputet pranë një komisioni të rëndësishëm, si Komisioni i Ligjeve, në një procedurë përzgjedhjeje dhe skanimi të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese, ka detyrim kushtetues, por edhe profesional të skanojë secilin kandidat, për të parë se ku janë këta kandidatë për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. A kemi ne sot kandidatët më të mirë të mundshëm dhe më të përgatitur profesionalisht për të hyrë në Gjykatën Kushtetuese? Unë mendoj se edhe në seancat e ardhshme ne kemi detyrim ta bëjmë këtë debat dhe të bëjmë pyetje. Shumë pak nga kolegët socialistë bënë pyetje dhe duket qartë që kandidaturat duheshin kaluar sa më shpejt.

Zoti Kryetar, mendoj se ne duhet të sqarojmë diçka sot si Kuvend. A do të veprojmë ne gjatë votimit për kandidaturat për Gjykatën Kushtetuese brenda kornizës kushtetuese, pra, a do ta respektojmë Kushtetutën dhe ligjin për Gjykatën Kushtetuese, apo do ta bëjmë këtë punë për të mirën e punës me një të rënë të lapsit? Se disa këtu janë mësuar t’i bëjnë gjërat me një të rënë të lapsit, siç bëhen listat elektorale të partive politike. Po këtu nuk jemi në një çështje të brendshme të një partie politike, por përballë një institucioni kushtetues dhe mendoj që ne duhet të zbatojmë ligjin për Gjykatën Kushtetuese, si dhe t’i përmbahemi Kushtetutës. Ta përkthej. Në leximin tim, dhe le të më sfidojnë kolegët juristë me eksperiencë qindrashekullore në jurisprudencë, mendoj se për secilin kandidat që do të zgjedhim, duhet një listë me tre kandidatë, pra duhet të zgjedhim një emër nga tre kandidatët. E thotë edhe ligji, zoti Kryetar.

Më lejoni ta gjej te neni 7/c! Nuk po e gjej, por ligji është i qartë që secila listë, për secilin anëtar të Gjykatës Kushtetuese, duhet të përmbajë tre kandidatë dhe unë ju kërkoj, zoti Kryetar, dhe shpresoj që edhe Këshilli për Legjislacionin të aplikojë Kushtetutën dhe ligjin në mënyrë strikte dhe të ftohtë. Ne këtu duhet të

na vijnë dy lista me nga tre kandidatë, me qëllim që sot të zgjedhim dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Kam edhe një çështje tjetër.

Çfarë ndodh me zonjën Arta Vorpsi? A është ajo anëtare e Gjykatës Kushtetuese, për sa kohë që nuk është betuar ende te Presidenti? Sepse kam frikë se do të procedojmë me një votim që do të rezultojë me mohimin e të drejtës së ndonjë kandidati, ndoshta më të përgatitur se kandidatët e tjerë, për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Kolegë, ju kërkoj të jemi striktë në zbatimin e Kushtetutës dhe t’i qëndrojmë besnikë procedurës parlamentare për përzgjedhjen e këtyre anëtarëve. Kaq kisha.

Shpresoj të iluminoheni më tepër nga Këshilli i Legjislacionit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Një minutë, zonja Spiropali! Ulu, zonja Spiropali!

Tri gjëra do të të them, meqë m’u drejtove disa herë, zoti Gjoni.

Së pari, në diskutimet tona nuk duhet të vëmë në diskutim çka është bërë me reformën në drejtësi deri më sot, që nga ndryshimet kushtetuese e deri te paketa ligjore prej 30 ligjesh. Kjo është bërë me objektivitet, me profesionalizëm dhe me realizëm dhe për këtë nuk duhet vënë në diskutim, të paktën Kuvendi, që e ka miratuar me 140 vota. Aktorë dhe faktorë të tjerë në Shqipëri, sigurisht, kanë të drejtën e mendimit të tyre, ashtu sikurse edhe për ne, që e kemi miratuar me 140 vota, siç e thatë edhe ju në diskutimin tuaj, koha sjell probleme, që kërkojnë përmirësime, refleksime e të tjera.

Së dyti, të 140 deputetët sot duhet të jenë të qartë se të gjithë përbetohemi për nenin e Kushtetutës, por sot jemi në ditën kur kemi vetëm një nen të Kushtetutës. Ne duhet të shprehemi sipas nenit 125, pika 2, për ata kandidatë që na ka përcjellë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili është i vetmi organ sovran, të tjerat janë “e të tjera” për deputetin në veçanti dhe për sallën në përgjithësi. Pra, sot kemi nenin 125, i cili thotë: “Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve...” Pra, këtu është fjala nëse do të zbatojë apo jo Kushtetutën për detyrimet që ka vetë Kuvendi. Kështu që sot jemi me detyrim për caktim në zbatim të nenit 125, pika 2.

Së treti, duhet të kemi parasysh dhe duhet të kemi më shumë respekt për instrumentet që kemi vetë si Kuvend. Në rastin konkret, njerëzit më profesionistë të grupimeve politike janë në Komisionin e Ligjeve dhe kanë ekskluzivitetin të skanojnë aplikuesit, sipas Kushtetutës, me profesionalizëm, objektivitet dhe realizëm. Ata e kanë bërë detyrën e tyre dhe ne nuk mund ta vëmë në diskutim sot.

Pavarësisht se nga vijnë kandidaturat, që vetaplikojnë nga seleksionimi që Kuvendi ia përcjell KED-së, organi sovran kushtetues dhe ligjor është KED-ja, e cila na thotë: “Këta tre emra keni, jo katër. Ju në daç votojini...” I votojmë apo nuk i votojmë, ne jemi sovran, por përsëri edhe ky sovraniteti ynë është i legjitimuar, që do të thotë se nëse ne nuk u japim kuorumi e nevojshëm të votave, përsëri KED-ja, në fund të fundit, është organ emërtese, që sjell tre kandidatë dhe na thotë: “Në qoftë se ju nuk plotësoni 140 vota, vakuum institucional nuk ka, i pari është automatikisht i shpallur”.

E fundit që kam në lidhje me kushtetutshmërinë e procedurave parlamentare për mënyrën e votimit është se ne kemi vetëm një instrument, Këshillin e Legjislacionit. Kjo është arsyeja që unë ditën e shtunë i kam drejtuar atij një letër, i kam vënë në dispozicion gjithë dokumentacionin dhe gjithë praktikën parlamentare. Ata janë në mbledhje. Të kemi besim se ata do të na sjellin një interpretim kushtetues. Kaq.

Zoti Balla, fjala është për ju.

Taulant Balla – Nuk kam çfarë t’u shtoj sqarimeve që bëri Kryetari i Kuvendit në aspektin procedural, por më vjen mirë që letra e Presidentit të Republikës sapo u lexua në këtë sallë nga një prej kolegëve deputetë të opozitës. Kjo është gjë e mirë, edhe në aspektin e dëgjimit të të gjitha argumenteve (edhe pse nuk ekzistojnë argumentet) lidhur me një çështje që kemi muaj që e kemi qartësuar.

Të mos harrojmë se ky diskutim është bërë në Kuvendin e Shqipërisë gjatë muajve janar, shkurt dhe mars, kur Kuvendi i Shqipërisë ka shpallur vakancat, pas vakancave të shpallura edhe nga Presidenti i Republikës.

E kemi ndjekur me vëmendje procesin nga ana e institucioneve përkatëse. Kujtoj këtu që Kuvendit i është dashur të rihapë... Për rastin e kandidaturës së tretë të Kuvendit procesi është

hapur. Nëse nuk plotësohet kuorumi i kandidaturave, procesi rihapet, siç e përcakton Kushtetuta.

U fol këtu për opinione apo për biseda të Komsionit të Venecies. Ka opinion Komisioni i Venecies, nuk ka biseda! Bisedat mbajini për vete, futini në xhep! Opinioni i Komisionit të Venecias është i qartë. Kur kemi hartuar paketën e reformës në drejtësi, parimi bazë ka qenë: t’u heqim institucioneve me përmbajtje politike, qoftë këtij Kuvendi apo Presidentit, të drejtën për të mbajtur peng Shqipërinë. Ia kemi hequr këtë të drejtë edhe Kuvendit, nëse nuk e bën detyrën. Edhe Presidentit të Republikës ia ka hequr këtë Kushtetuta.

Po lexoj fjalë për fjalë opinionin e Komsionit të Venecies: “Me fillimin e 30 ditëve nxitet mekanizmi antibllokim, mekanizmi zhblllokues. Është në natyrën e mekanizmit zhblllokues për të siguruar funksionimin e institucionit shtetëror. Një mekanizëm zhblllokues synon të shmangë ngërçin. Synimi i ligjvënësit mund të ishte vetëm të sigurojë një mekanizëm për të shmangur ngërçin e moszgjedhjes anëtar të Gjykatës Kushtetuese”.

Kështu thotë opinioni i vyer i Komisionit të Venecies. Po lexoj fjalën e fundit, që është më e rëndësishme: “Vetëm me zgjedhjen e kandidatit sigurohet funksionimi i një institucioni shtetëror”. Pra, më troç nuk ka!

Tani, kur zgjidhet?

Së pari, që ta sqarojmë për të gjithë, miq, thelbi i reformës në drejtësi ka qenë të heqim dorë nga historia 28-vjeçare, që politika zgjedh anëtarët e sistemit të drejtësisë. Për fat të mirë ia kemi hequr këtë të drejtë politikës te Gjykata e Lartë, por kemi lënë parimin e *check and balance*, kontrollo dhe balanco, në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese. Tre i zgjedh Presidenti, tre i zgjedh Kuvendi dhe tre Gjykata e Lartë. Po si? Ia kemi dhënë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Për ata që nuk e dinë ende, institucioni bazë për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk është as Presidenti, as Kuvendi, as Gjykata e Lartë, por është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në të cilin aplikojnë 700 veta dhe ai të sjell vetëm tri kandidatura të rankuara.

Presidenti i Republikës ka afat. Kuvendi i Shqipërisë ka afat.

Ka dalë sot që në pikë të mëngjesit nga kafja me njërin që e pi përditë dhe thotë: “Kuvendi i Shqipërisë ka shkelur afatin, është me vonesë”.

Si kështu, more lum miku, unë qenkam me vonesë, që po e bëj brenda afatit, dhe ti, që të ka mbaruar afati që javën e kaluar, qenke në rregull?! Jo, more zotëri! Presidenti i Republikës, për kandidaturën e dytë, që i takon, kishte 30 ditë kohë, nga data 7 tetor deri në datën 7 nëntor. Në datën 8 nëntor i ka mbaruar afati Presidentit të Republikës.

Shpikje e re kushtetuese! Presidenti i Republikës paska të drejtë të pezullojë Kushtetutën, të pezullojë afatet!

Me këtë precedent të rëndë kushtetues, Presidenti do të dalë nesër dhe do të thotë: “Pezulloj afatin 5-vjeçar të Presidentit të Republikës. Do ta bëj 50 vjet, deri kur të më teket mua! Dekret! Kam të drejtë që 5 vjetët e mi t'i bëj 50. Kam të drejtë që mandatin e Ralf Gjonit ta bëj 50 vjet”. Kështu?! Jo, more zotëri!

E ka të përcaktuar qartë. Dëgjoji mirë ata që... E ka shumë mirë të përcaktuar, 30 ditë. Në fund të 30 ditëve, institucioni bazë i emërimeve në drejtësi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, thotë: “Zotëri, afati yt mbaroi. I pari i rankuar me pikë, me një diferencë nga tjetri apo pa diferencë (nuk e di, se nuk i kam parë pikët e rankimit në rastin e treshes së Presidentit)...” Them “të treshes së Presidentit”, sepse Kushtetuta flet për tri kandidatura. Presidenti nuk i ezauroi...

Dua t'i them zonjës Arta Vorpsi urime për detyrën e marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pas përfundimit të procesit!

Pra, që ta dinë, aktualisht kemi tre anëtarë në Gjykatën Kushtetuese. Kemi zonjën që është në detyrë, zotin Besnik Muçi, që është dekretuar nga Presidenti, zonjën Arta Vorpsi, kandidaturë për të cilën ka përfunduar afati 30-ditor nga Presidenti dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka bërë emërimin, siç e thotë, meqë u kërkua edhe opinion nga Komisioni i Venecies, është Komisioni i Venecies, dhe ne do të zgjedhim edhe dy kandidatura sot. Pesë kandidatura, pesë anëtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese. Ky është një lajm i mirë për rrugën tonë europiane.

Historikisht, ky është viti im i katërmëdhjetë në këtë sallë dhe, të them të drejtën, një gjë e kam merak, më pëlqen që këtu

të flasim troç, jo me maska, se unë nuk flas kurrë me maska.

Presidenti i Republikës bën mirë të heqë maskën dhe të dalë të flasë troç. Presidenti i Republikës nuk ka hallin e Kushtetutës, as hallin e afatit. Ta themi tani, ai nuk ka hallin e afatit! Presidenti i Republikës ka ngulmuar që lista nga KED-ja t'i shkojë me katër veta, sepse ka parë që e katërta e renditur është një person tek i cili ka besim, sipas tij, ka njohje.

O lum miku, Presidenti i Republikës do të çojë në Kushtetuese bashkëjetuesen e Alibeajt! Tani, le të dalë ai zotëria dhe të thotë është apo jo kështu. Kjo është troç. Lërimi dënglat!

Presidenti i Republikës nuk ka hall as afatin kushtetues, as kriteret, as të na këndojë atë këngën “e kam unë, e ke ti”.

Ore zotëri, nëse do të të lexoj Kushtetutën, Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë të bëjë të tretin! Meqë të parin e zgjidhka Presidenti, meqë të dytin e zgjidhka Kuvendi, të tretin e ka Gjykata e Lartë! Kjo do të thotë se ne duhet të presim, por ky parim zbatohet në rastin kur Gjykata Kushtetuese i ka të nëntë anëtarët dhe përfundimi i mandatit të anëtarit të parë zëvendësohet nga Presidenti, përfundimi i mandatit të anëtarit tjetër zëvendësohet nga... Këtu nuk bëhet fjalë që kemi nëntë anëtarë, që iku i nënti dhe po zëvendësojmë të nëntin. Këtu bëhet fjalë që kemi vetëm një atje, edhe ky me mandat të përfunduar, por rri në detyrë për shkak të zëvendësimit, dhe kemi tetë vakanca. Për këto tetë vakanca...

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, more djalë, kështu!

Sepse nëse do të kishte të drejtë, ky proces duhet të ishte kontestuar që në shkurt të këtij viti, jo sot, por edhe atëherë ka prevaluar rëndësia e zëvendësimit të tyre.

U them gjithë kolegëve deputetë që, në aspektin kushtetues, ky është një proces kristal, i rregullt. Ky është një proces që do t'i japë Shqipërisë Gjykatën Kushtetuese funksionale dhe është në nderin e detyrës e secilit deputet, që ka ardhur në këtë sallë, siç ne kemi marrë mandatin nga ky popull, për ta mbështetur dhe për ta çuar reformën e drejtësisë deri në fund. Ata që duan ta pengojnë reformën në drejtësi e kanë marrë përgjigjen.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Gjoni, 2 minuta.

Ralf Gjoni – Ju falënderoj, zoti Kryetar!

Zoti Balla, më kujtuat këngën që këndoi Myslim Murrizi këtu përpara ca javësh: “E kam unë, e ke ti, moj Dudi, moj Dudi, ku më ha mu e ku më kruan ti”. Tani nuk e kuptoj përse më drejtosh mua për Presidentin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka pas me ty, Myslim, prej miqësisë.

Taulant, unë nuk fola fare për Presidentin dhe të them të drejtën, tentova ta lexoj letrën e tij, por m'u duk shumë e komplikuar, shumë e gjatë dhe nuk e kuptova shumë.

Unë po flas vetëm për mënyrën se si do të zgjedhë parlamenti. Unë nuk jam kundër, përkundrazi, ejani t'i zgjedhim 3 apo 4 anëtarë sot, nëse doni. Kush ju ka penguar t'i zgjidhni deri tani anëtarët e Gjykatës Kushtetuese? Unë citova nenin 7/c, ku thuhet: “Pas seancave Komisioni i Ligjeve i dërgon Kuvendit emrat e tre kandidatëve për çdo vend vakant, bashkë me raportin e arsyetuar për secilin kandidat të përzgjedhur”. Pra, fola vetëm për procedurën.

Zoti Balla, unë mendoj që kandidaturat që do të zgjedhim, një apo dy, për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duhet të dalin nga dy lista të veçanta dhe secila listë të ketë 3 emra. Kaq kërkonte unë. Pra, të jemi në respektim të Kushtetutës dhe brenda kornizës ligjore, me qëllim që përzgjedhja jonë dhe votimi që do të bëhet këtu të mos jetë i kontestueshëm nesër ose pasnesër. Nuk besoj se kolegët socialistë janë kundër respektimit të procedurave ligjore të Kuvendit dhe Kushtetutës. Nuk e kuptoj pse ka kaq debat për këtë problem.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Arlind Çaçanin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala për Selami Jenishehrin. Të përgatitet Halil Jakimi.

Selami Jenishehri – I nderuar Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Gramoz Ruçi,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar shqiptarë, që na ndiqni brenda dhe jashtë vendit tonë,

Plotësimi i Gjykatës Kushtetuese me anëtarë është një nga punët më urgjente dhe më të rëndësishme që kemi aktualisht, prandaj duhet të tregojmë përgjegjshmëri në përzgjedhjen e tyre, sepse kemi mësim shumë të hidhura nga ish-Gjykata Kushtetuese, e cila, sipas meje, kanë

qenë faktori i shkatërrimit shumë rëndë të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Ajo shkaktoi pasoja të rënda, që vështirë se do të rregullohen, ja përse. Ish-Gjykata Kushtetuese shfuqizoi nenin 315 të Kodit Penal, ku gjyqtari që merrte një vendim të padrejtë dënohej me burg. Pra, e shfuqizoi këtë nen dhe gjyqtari, i cili jep një vendim të padrejtë nuk shqetësohet, sepse nuk e kap ligji. Ky veprim u pasua me vendime të hapura në kundërshtim me ligjin, duke përvetësuar pasuritë e qytetarëve krejt haptazi në mënyrë të paligjshme dhe pastaj vetingu i nxori nga sistemi i drejtësisë. Po kush ishte fajtori? Ishte ish-Gjykata Kushtetuese me shfuqizimin që i bëri ligjit, sepse në të kundërt gjyqtarët shkonin në burg. Kjo është arsyeja që gjykatat sot janë të përgjysmuara dhe nuk funksionojnë, sepse presin zëvendësimin me gjyqtarë të rinj.

Po gjyqtarët e rinj a nuk janë në pozitat e gjyqtarëve që ikën nga vetingu? SPAK-u do të hetojë dhe do të çojë peshqit e mëdhenj në gjykatë. Këta janë ata që kanë përvetësuar qindra e miliona euro, të cilët, për t'i shpëtuar dënimit të madh, do të paguajnë shumat qindra milionë euros dhe do të marrin pafajësinë e tyre. Pra, këto shuma do t'i bëjnë gjyqtarët e rinj t'i kthejnë shpinën drejtësisë dhe popullit. Këtë e them me siguri, sepse edhe i zgjedhuri nga organet e vetingut, gjyqtari Dritan Hallunaj ka dhanë vendime që dihen se janë të padrejta. Ai në vendimet e tij thotë se një sipërfaqe nën një ndërtesë është pemishte, arë e të tjera. Të tilla janë vendimet e tij, për këtë mund të lexoni vendimin nr. 1680, datë 30.10.2003. Po ku është sot ky person? Sot është në KLGJ. Pra, ky gjyqtar do të kontrollojë gjyqtarët e tjerë.

Me shfuqizimin e nenit 315 të Kodit Penal gjyqtarët e rinj do të vazhdojnë të bëjnë namin mbi popullin. Për këtë ne heshtim dhe kjo është e papranueshme, sepse ky popull na ka zgjedhur ne për të rregulluar këtë drejtësi që tani mungon në Shqipëri.

A nuk është në konflikt interesi Gjykata Kushtetuese, kur shfuqizon nenin 315 të Kodit Penal dhe u thotë gjyqtarëve që nuk do të dënoheni nëse merrni vendime të padrejta, sepse edhe ata vetë janë gjyqtarë? Kjo është detyra jonë dhe është në nderin tonë që t'ia heqim litarin që ka në fyt populli, që i merr të drejtën që ia jep ligji. Pra, ne duhet ta vëmë në fuqi nenin 315 të Kodit Penal, që gjyqtarët që marrin

vendime të padrejta të shkojnë në burg. Pa bërë këtë detyrë, ne nuk mund të jemi përfaqësues të ndershëm të popullit shqiptar, i cili na ka besuar dhe respektuar kaq shumë. Prandaj ne duhet të bëjmë kujdes kur të votojmë për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, që të mos jenë si ata të mëparshmit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Halil Jakimin. Të përgatitet Halit Valteri.

Halil Jakimi – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Mbaj mend që, kur u votua reforma në drejtësi, kjo sallë ishte e mbushur plot, edhe me përfaqësues të trupave diplomatike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian. Po ashtu në këtë sallë votuan 140 deputetë që kjo reformë të jetësohej. Dihet që interesin më të madh në ngritjen e kësaj reforme e kanë qytetarët shqiptarë. Pa dyshim që duhen falënderuar shumë edhe mediet që përcjellin informacione të qytetarët për reformën.

Një nga arsytet që unë pranova mandatin e deputetit ka qenë reforma në drejtësi. Unë e mbështes reformën në drejtësi, sepse shqiptarët e kanë vuajtur padrejtësinë në vite. Shqiptarët janë vjedhur, kanë humbur pronat, kanë bërë vetëgjyqësi dhe shumë herë janë vrarë për së dyti, kjo sepse nuk i besojnë këtij sistemi që kemi sot. Ky sistem është jetësuar prej 28 vjetësh dhe gjithmonë unë e kam quajtur sistemi i padrejtësisë.

Sot ne kemi rastin ta kthejmë besimin të drejtësisë dhe të tregojmë që kjo reformë nuk është vetëm për sy faqe të ndërkombëtarët, por është një reformë, me të cilën ne synojmë të krijojmë një sistem të shëndoshë dhe peshorja të gjykojë drejt si të pasurit dhe të varfrit; si prokurorët dhe gjyqtarët; si oligarkët dhe politikanët, pra të jetë i drejtë për çdo qenie që jeton në këtë shoqëri.

Ne jemi shtet demokratik dhe kjo më bën shumë përshtypje, edhe si një i ri i këtij vendi dhe jo vetëm si deputet, që për çështje të rëndësishme, si për ndërtimin e organeve dhe institucioneve të vendit tonë, ende ju nuk bini dakord, por diskutoni: jo procedura, jo rregulli e jo kjo dhe jo ajo. Për mendimin tim, kjo është e patolerueshme, sepse ne jemi një shtet sovran me një demokraci pothuajse 30-vjeçare dhe ende

nuk kemi bërë një institucion kushtetues solid, ku ne të bazohemi ose të referohemi për çdo ngërç politik.

Zoti President, unë e lexova letrën tuaj, edhe pse nuk më njeh si deputet i këtij Kuvendi. Unë në ndërgjegjen time jam i vendosur ta mbështes reformën që duan qytetarët e këtij vendi dhe të jem në anën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian ku ne synojmë të aderojmë.

Shpresoj që ky votim të krijojë një reformë që të ndajë njëherë e mirë shapin nga sheqeri, pra të kaluarën e errët që ka pasur sistemi ynë prej 30 vjetësh. Do të doja që në këtë sallë të ishin edhe përfaqësuesit e trupave diplomatike, të cilët e kanë ndjekur dhe e kanë mbështetur këtë proces, por, meqë ata nuk janë, gjej rastin t'i falënderoj, pasi pa ndihmën e tyre ky proces nuk do të ishte i mundur të arrihej në këtë pikë.

Unë shpresoj që me ngritjen e këtij sistemi dhe të kësaj reforme qytetarët shqiptarë do të gjejnë drejtësinë e munguar ndër vite, gjithashtu të trajtohen edhe ato çështje dhe dosje që janë bërë stok pa fund, ku deri tani llogariten rreth 32 mijë, ndërsa vetëgjyqësia akoma vazhdon, ku njerëzit dhe qytetarët ndoshta me të drejtë vriten rrugëve si qen.

Të dashur qytetarë, po ju drejtohem ju dhe asnjë politikani në veçanti dhe as klasës politike në këta 30 vjet, unë sot votoj për ngritjen e një sistemi drejtësie të shumëpritur, duke u udhëhequr nga interesat e popullit tim dhe duke qenë në një linjë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian. Po ushtroj vullnetin tuaj, duke menduar që po bëj më të mirën për popullin tim.

Zoti ju bekoftë ju! Zoti e bekoftë Shqipërinë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Halit Valterin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tërhiqet.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjala për Andrea Marton.

Andrea Marto – I nderuar Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të dashur kolegë,

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Eksplorimit Shkencor në Detin Mesdhe, si dhe angazhimi i vendit tonë në

zhvillimin e mbrojtjen e detit Mesdhe dhe të deteve të tjera që kontribuojnë në këtë det.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor të Detit Mesdhe është një organizatë ndërqeveritare me seli në Marok. Komisioni përbëhet nga të deleguarit e shteteve nënshkruese që lagen nga deti Mesdhe dhe nga detet e tjera që e përbëjnë këtë det, si dhe nga të deleguarit e qeverive të shteteve nënshkruese, që nuk lagen nga ky det, por që kryejnë hulumtime, studime dhe punë oqeano-analogjike në këtë det.

Pranimi në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor të Detit Mesdhe të shteteve që nuk lagen nga deti Mesdhe bëhet me miratimin e dy të tretave të anëtarëve, ndërsa presidenca e komisionit i takon njërit prej shteteve nënshkruese që lagen nga deti Mesdhe.

Ideja për krijimin e një organizimi, që do të merrej me studimin shkencor të detit Mesdhe, u hodh që në fillimet e shekullit të kaluar. Ishte viti 1908 kur u diskutua për krijimin e një organizimi të tillë, në zhvillim të industrisë së peshkimit. Komiteti u themelua në Gjenevë më 30 mars të vitit 1990 dhe kryesohej në atë kohë nga princi i Monakos, Alberti II. Gjatë periudhës 1919-1939 u krijuan shumë observatorë detarë rreth Mesdheut, si në Algjeri, Tunizi, Itali e të tjera. Në vitin 1951 “rilind” komiteti dhe që prej vitit 1992 kongreset e këtij komisioni realizohen një herë në 3 vjet. Kryetari aktual i komisionit është princi i Monakos, Alberti II. Në këtë komision janë të anëtarësuar 23 shtete, të cilat lagen nga deti Mesdhe dhe detet që e përbëjnë atë, por edhe nga vende të tjera dhe ka shkencëtarë nga 30 vende të ndryshme të botës. Komisioni përbëhet nga 6 komitete të cilat janë: shkenca detare, klima dhe fizika e oqeanit, biogjeokimia detare, mikrogjeologjia dhe bioteknologjia detare, ekosistemet detare dhe burimet e gjalla, si dhe sistemet bregdetare.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor të Detit Mesdhe ka si objekt dhe qëllim të kontribuojë për zbulimin dhe mbrojtjen e detit Mesdhe dhe të deteve që lidhen me të, duke favorizuar punimet hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat kombëtare, që kanë qëllime të ngjashme, duke nxitur programe multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar, duke lehtësuar shkëmbimin e informacioneve, veçanërisht botimet në fushën e

oqeanografisë, biologjisë ujore, biologjisë pyjore dhe biogjeokimisë.

Shtetet nënshkruese u angazhuan që për një periudhë 5-vjeçare, e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër 5-vjeçare. Shtetet nënshkruese mbështetin një rrjet me disa mijëra studiues detarë, të cilët përdorin mjetet e fundit shkencore për të kuptuar, për të monitoruar dhe për ta mbrojtur më mirë detin Mesdhe, i cili ndryshon shpejt dhe po sjell ndikime të mëdha në mjedis dhe në ekonomi.

Me anëtarësimin në këtë Komision, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare nëpërmjet projekteve të shumta për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë. Komisioni integron një spektër të gjerë disiplinash detare, duke përfshirë proceset gjeofizike, kimike dhe biologjike së bashku me hartat me rezolucion të lartë të fundit të detit. Angazhimi si anëtarë në Komisionin Ndërkombëtar të Eksplorimit Shkencor të Detit Mesdhe sjell detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor të përcaktuar nga Byroja. Ky kontribut për Shqipërinë është 25 mijë euro.

Me hartimin e këtij projektligji, si rezultat i aderimit në këtë Komision, i cili në kuadër të nismës për zhvillimin e qëndrueshëm financiar të zonave të mbrojtura detare të Mesdheut, nën kujdesin e princit Alberti II i Monakos, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme për të mbajtur dhe për ta zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Së dyti, kjo nismë ka një rëndësi rajonale, pasi ndjek një politikë ambicioze për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura. Gjithashtu, ajo do të investojë në forcimin e vlerave ekologjike, sociale dhe ekonomike, duke inkurajuar krijimin e zonave të mbrojtura detare të reja, si dhe përmbledhjen e fondeve për plotësimin e sistemit aktual të financimit nëpërmjet mekanizmave inovativë.

Për sa më sipër, ftoj të gjithë kolegët që ta votojmë unanimisht këtë projektligj.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Marto!

Këtu mbaron diskutimi në parim për projektligjin “Për aderimin e Republikës së

Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor”. Kjo është nismë e deputetit Ilir Beqaj. Nëse deputeti dëshiron ta prezantojë nismën, është i mirëpritur.

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bazë të nenit 73, pika 2, të Rregullores, nismëtari ka të drejtë ta prezantojë nismën pa ndonjë kufizim kohor.

Për të diskutuar për projektligjin janë regjistruar: nga Grupi Parlamentar Demokrat deputetët Myslim Murri dhe Halit Valteri; nga Grupi Parlamentar i Pavarur, deputeti Nimet Musaj; nga deputetët jashtë grupeve parlamentare është deputeti Artur Roshi dhe, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, është regjistruar deputeti Arben Ahmetaj.

Fjalën e ka nismëtari për të prezantuar nismën.

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Në datën 13 shtator 2019, siç ju edhe e dini, kam depozituar këtë nismë ligjore lidhur me gjobat e vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në periudhën korrik–gusht 2019.

AKU-ja në periudhën korrik–gusht u ka vendosur 52 gjoba me vlerë mesatare secila rreth 15 milionë lekë subjekteve, të cilat nuk ishin të pajisura me një leje të veçantë profesionale për prodhim ushqimesh. Një pjesë e këtyre subjekteve kanë një qarkullim vjetor jo më shumë se 40 apo 50 milionë lekë, pra i gjobisim me një vlerë sa 1/3-ta e gjithë xhiros vjetore.

Në fakt, vetë AKU-ja për të njëjtën shkelje nga janari në qershor ka vendosur 4 gjoba çdo muaj dhe në shtator 3 gjoba. Subjektet kanë vite që operojnë në treg. Mund të kenë qenë në shkelje të ligjit, duke mos e pasur këtë licencë prej vitesh, por kishin funksionuar dhe kanë bashkëjetuar me situatën e moszbatimit të ligjit. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm për periudhën korrik–gusht 2019 janë paraqitur 1430 kërkesa për t’u pajisur me një licencë të tillë, pra 10 herë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ndërkohë po në këtë

periudhë 75% e kërkesave janë pranuar. Pra, këto subjekte e kanë marrë licencën në të njëjtën periudhë.

Nga sa më sipër, kam arritur në vlerësimet se shumica dërrmuese e subjekteve prej vitesh nuk e kanë ditur që janë në moszbatim të ligjit; shumica dërrmuese, me të marrë informacion direkt apo indirekt, aplikuan për t’u pajisur me licencë dhe e morën licencën. Gjobat janë vendosur në mënyrë disproporcionale vetëm në periudhën korrik–gusht. Për të zbuluar se subjektet janë në kushtet e moszbatimit të ligjit për mungesën kësaj licencë nuk është e nevojshme që AKU-ja të bëjë inspekte, por mjafton që të kontrollojë databazën e Qendrës Kombëtare të Biznesit për të parë se cili e ka dhe cili nuk e ka këtë licencë.

AKU-ja në një fazë të parë, mund të kishte bërë njoftime paralajmëruese për subjektet që i vlerësonte se ishin në kushtet e moszbatimit të ligjit.

Bazuar në sa më sipër, kam ndërmarrë nismën ligjore për faljen e gjobave, sepse jo vetëm i kam gjykuar disproporcionale, por edhe për të evituar kalvarin e subjekteve në hallkat e apelimit administrativ apo të drejtësisë administrative.

Kjo nismë është shoqëruar fillimisht me dy çudi të Kuvendit tonë.

Së pari, jam përpjekur si deputet të kërkoj një zgjidhje ligjore për një anomali, sipas mendimit tim, të ndodhur në dëm të një grupi qytetarësh që merren me sipërmarrje, që lidhen direkt apo indirekt me ushqimin.

Kërkoj të zgjidh një situatë të ndodhur në dy muaj, ndërkohë që vetë Kuvendit i janë dashur 2 muaj, nga data 13 shtator që të vijmë sot për të diskutuar në seancë.

Së dyti, komisioni përgjegjës për diskutimin e këtij projektligji është caktuar nga Konferenca e Kryetarëve, Komisioni i Ekonomisë. Këto gjoba burojnë nga vetë ligji i ushqimit. Ligji i ushqimit në variantin e tij të parë apo të amendimeve nuk diskutohet te Komisioni i Ekonomisë, por diskutohet në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, si komisioni përgjegjës për këtë fushë, dhe në komisione të tjera.

Konferenca e Kryetarëve nuk e ka gjykuar të arsyeshme ta përcjellë në komisionin përgjegjës për fushën e përgjegjësisë.

Komisioni i Ekonomisë i propozon seancës ta rrëzojë në parim nismën me arsyetimin se është antikushtetues.

Pa dashur të cenoj as njohuritë, as seriozitetin e analizës, as integritetin e asnjë prej kolegëve të mi të Komisionit të Ekonomisë, a nuk kemi ne në Kuvend një komision të caktuar që merret mirëfilli me Kushtetutën dhe me kushtetutshmërinë? Besoj se biem dakord se, së pari, për kushtetutshmërinë duhet të shprehet Komisioni i Ligjeve. Për mua mbetet e çuditshme, sepse, meqenëse bëhet fjalë për gjoba dhe gjoba ka një vlerë monetare, kjo çështje është ekskluzivitet i Komisionit të Ekonomisë.

Le të kthehemi te thelbi i diskutimeve.

Së pari, dua të falënderoj të gjithë kolegët e Komisionit të Ekonomisë, pavarësisht se si votuan, për seriozitetin e diskutimit në komision dhe për frymën konstruktive të debateve. Me shumicë votash, komisioni vendosi t'i propozojë seancës ta rrëzojë në parim këtë nismë, me arsyetimin se mosnjohja e ligjit nuk është justifikim për moszbatimin e ligjit dhe me arsyetimin e cenimit të barazisë.

Për mendimin tim, arsyetimi i cenimit të barazisë nuk qëndron, sepse në çdo rast, kur bëhet fjalë një falje, ka një trajtim të pabarabartë, por falja është akt politik, që vishet me një petk ligjor. Falje janë bërë herë pas here, qoftë penale, qoftë administrative. Amnistitë kanë pabarazi. Dikush është dënuar për një vepër penale dhe e ka kryer të plotë dënimin; dikush tjetër është dënuar me të njëjtën masë për të njëjtën vepër penale, por në një moment amnistie kryen një dënim më të pjesshëm.

Falje të detyrimeve tatimore janë bërë herë pas here. Kush i ka paguar rregullisht detyrimet, është në situatë të pabarabartë me dikë tjetër që nuk i ka paguar detyrimet, por falen. Besoj se çfarë ka ndodhur me sjelljen e AKU-së në muajt korrik–gusht duhet të na bëjë të vetëdijshëm për një aspekt shqetësues dhe duhet të përpiqemi që ta ndalojmë, që të mos kthehet në dukuri: atë të mosveprimit të shtetit për një periudhë të caktuar. Detyrimi për t'u pajisur me licencën në fjalë është që prej 2009-s. Çfarë kemi bërë në 6 vjet që qeverisim? A ka brenda sferës të sigurisë ushqimore aspekte të tjera të mosveprimit të shtetit? A kemi një analizë 360 gradë të aspekteve të ndryshme të mosveprimit të shtetit? Në kushtet e mosveprimit të shtetit për një

periudhë të caktuar, për mendimin tim, gjoba nuk mund të jetë instrumenti me të cilin shteti vendos të rivendosë autoritetin e tij.

Cili është raporti midis moszbatimit të ligjit nga subjektet e ndryshme dhe mosveprimit të shtetit? A duhet të vendosim një rregull, qoftë të pashkruar, që, në rastet e mosveprimit të shtetit, të mos i ndëshkojmë subjektet?

Kolege dhe kolegë,

Ju kërkoj që, kur të ftoheni të votoni për nismën që unë propozoj, t'ia bëni këtë pyetje vetes dhe pastaj të votoni si ta gjykoni të arsyeshme.

Secilit prej jush, që tashmë e ka marrë vendimin paraprak për të votuar kundër, dua t'i bëj edhe një pyetje tjetër.

Në korrik –gusht 2019 janë gjobitur 52 subjekte; në korrik – gusht 2019 kanë aplikuar për t'u pajisur me licencë 1430 subjekte; 52 të gjobitur nga 1430 në situatë të moszbatimit të ligjit. Kjo është barazi, apo pabarazi? Si u zgjodhën këta 52 midis 1430 subjekteve që nuk kishin licencë? Përgjigjuni me vete këtyre pyetjeve dhe pastaj gjykojeni vetë si do të votoni.

Faleminderit !

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Beqaj!

A keni ndonjë pyetje për nismëtarin? Nëse nuk keni, kalojmë në listën e diskutantëve.

Fjalën e ka deputeti Nimet Musaj.

Të përgatitet deputeti Myslim Murri.

Nimet Musaj – Faleminderit, zonja Nënkrjetare!

Të nderuar kolegë,

Së pari, lejomëni, nga një shikim i përgjithshëm që i bëra këtij projektligji, ta përsërisht zotin Ilir Beqaj, nismëtarin e këtij projektligji, një deputet shumë aktiv edhe në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, ku unë bëj pjesë. E vlerësoj zotin Beqaj për nismat e tij të herëpashershme edhe në Kuvend, për të cilin kam një vlerësim dhe duhet respektuar.

Së dyti, serish pa u thelluar, e vlerësoj që sot kemi përpara një nismë ligjore, që synon oksigjenimin e bizneseve të fushës ushqimore, duke u mundësuar këtyre të fundit faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar Ushqimor.

Së treti, për t'u përshëndetur është fakti që, ndryshe nga 30 vjet, sot përfitues nga kjo falje gjobash, janë kryesisht njësitë e vogla dhe të

mesme tregtare. Në 30 vjet, kryesisht nga këtu, përparësi u është dhënë faljes së bizneseve të mëdha. Megjithatë, këtu po shkoj më në thellësi të problemit, e dini se për çfarë më pyeti një pensionist nga qyteti im?! Ai, i informuar nga mediet për këtë nismë që shqyrtojmë sot, ma ktheu të gjithë pikëpamjet personale që kisha më parë mbi çështjen që po diskutojmë sot. Pyetja që m'u drejtua ishte: te ushqimi e gjetët të falni ju?

Isha nisur në këtë seancë për të votuar pro këtij projektligji. Siç e thashë edhe më sipër, isha nisur nga një konsideratë personale tejet pozitive që kam për ish-ministrin Beqaj, por kjo pyetje me lëkundi jo pak.

Çfarë jemi duke bërë ne sot?! Çfarë po diskutojmë? Po falim gjobat e operatorëve që të palicencuar prodhonin tregtonin dhe shpërndanin ushqime të pasigurta dhe cilësore për shqiptarët.

Kemi dëgjuar për nxënës të helmuar kopshtesh, kemi dëgjuar për nxënës të helmuar shkollash, kemi dëgjuar për dasmorë të helmuar e për shqiptarë të helmuar dhe sot jemi këtu të falim tregtuesit e produkteve të pasigurta për detyrimet që i kanë shtetit shqiptar. A është e drejtë kjo ndaj konsumatorit shqiptar?! Konsumatorët thonë: "Jo". A është e drejtë kjo ndaj vetë ministrisë që zoti Beqaj dikur drejtonte, sepse në bindjen time në atë kohë zoti Beqaj ka qenë një nga drejtuesit më efektivë që ky dikaster ka pasur?! Sot le ta japë vetë ministrja përgjigjen e kësaj pyetjeje. Helmimi, përveçse është një rrezik shëndetësor për popullatën, është edhe një kosto për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e rasteve nga institucionet shëndetësore. Kush do ta mbulojë këtë kosto, përveç tregtarëve të ushqimeve të pasigurta?! Qytetari shqiptar, taksapaguesi dhe konsumatori thonë: "Jo". A është e drejtë kjo ndaj fëmijëve tanë? Si t'ua shpjegojmë ne atyre që disa operatorëve, të cilët na detyronin t'ju ushqenim me produkte të pasigurta dhe tani u ka ardhur vakti për t'u formalizuar, duam t'u falim gjobat?! A kemi një studim paraprak sesi janë të dhënat shifrore të përfitimeve të pritshme të ekonomisë shqiptare, nëse ecim në drejtimin që propozohet sot?! Unë mendoj se janë të papërfillshme para asaj që çdo raport ndërkombëtar bën thirrje për të treguar kujdes të vazhdueshëm në drejtim të sigurisë ushqimore edhe nëse, siç e thotë raporti, ky projektligj nuk është kërkesë e Bashkimit

European. Por, të nderuar kolegë, siguria ushqimore është dhe do të mbetet në qendër të vëmendjes sonë. Çfarë ka më të rëndësishme se siguria ushqimore e familjeve tona?! Asgjë nuk ka mbi të. A duhet të mblidhemi këtu për faljen e gjobave të disa operatorëve, apo për të çuar disa hapa parpara cilësinë e produkteve që u servirim shqiptarëve?! Unë e di që qeveria shqiptare është për të ecur më shumë përkrah së dytës, prandaj edhe unë propozoj të njëjtën gjë: sigurinë ushqimore përpara oksigjenimit të tregut ushqimor.

Një problematikë tjetër që hasim në këtë projektligj është edhe pabarazia e operatorëve midis atyre që nuk vonuan dhe shkuan menjëherë për të paguar detyrimet e tyre dhe atyre që nuk i paguan. Si do t'ua shpjegojmë ne atyre pabarazinë që po i vendosim përpara konkurrentëve në një sektor kaq delikat?! Ne do t'u themi atyre që ju i paguat detyrimet, por sot po falim këta që vonuan ta bënin këtë dje. Si do t'ua shpjegojmë operatorëve të rregullt barazimin dhe njësimin, deri dje me të parregulltit, në një nga tregjet me delikate siç është ushqimi?! Ne do t'u themi që ju ishit të rregullt në këtë proces, por vazhdoni të garoni me të parregulltit e djeshëm.

Po kthehem te pyetja e pensionistit nga zona ime elektorale. Tek ushqimi e gjetëm të falim në këtë moment vetëm një pjesë të këtyre bizneseve? Ndaj, sa më takon mua, këtu flas personalisht dhe jo në emër të grupit, këtë projektligj e abstenoj. Në këndvështrimin tim, tregtia e rregullt në lëmin e ushqimeve nuk meriton mundësi të dytë. Ne duhet të japim mesazhe të qarta nga kjo foltore që, mbi gjithçka, me sigurinë ushqimore të shqiptarëve nuk mund të luhet.

Duke qenë se nga të dhënat paraprake unë vërej se përfituesit dhe përfitimet janë nga njësi të vogla e të mesme, mendoj se ka vend edhe për një shkallëzim të tolerancës. Nuk mund të ofrojmë njësoj e njëhershëm falje kudo dhe për këdo, si për dikë që ka vetëm një dokument të parinovuar, ashtu edhe për dikë që gjithë kohën e tregtimit të tij e ka mbështetur në pasiguri.

Unë dua të mbështes fort këto njësi tregtimi prodhimi dhe tregtimi shpërndarjeje, por falja e menjëhershme e të gjithave e pashkallëzuar nuk më duket e shëndetshme në planin e përgjithshëm. Ndaj, nëse do të ishte mundësia,

do t'u propozoj kolegëve të nderuar një shkallëzim të kategorive përfituese.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi- Faleminderit, zoti Musaj!

Zoti Beqaj, fjalën e doni për procedurë, apo për replikë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për replikë. Teknika, ju lutem 2 minuta kohë.

Ilir Beqaj – I nderuar koleg,

Dua ta qetësosh pensionistin që të ka ngritur një shqetësim të drejtë sot. Subjektet që janë gjobitur, ashtu siç e thatë edhe ju, janë subjekte të vogla. Dikush në Fier ka pasur prej 7 vjetësh një licencë biznesi për të shitur hamburger, kushte të mira higjieno-sanitare dhe certifikatë higjieno-sanitare, por prej 7 vjetësh nuk i ka kërkuar njeri që hamburgerin, i cili është mish që grihet dhe pastaj bashkohet në një temperaturë të caktuar, ta quajë prodhim ushqimor. Kjo ka qenë letra që ai nuk e ka pasur, siç e ka pasur një fabrikë sallami apo dikush që duhet ta ketë, dhe për këtë letër, të cilën nuk e ka pasur prej 7 vjetësh ai dhe asnjë prodhues hamburgeri, apo asnjë prodhues byreqesh në të gjithë Shqipërinë, të cilëve u është kërkuar ta kenë, por nuk e kishin, janë gjobitur me 15 milionë lekë. Nuk cenojnë higjienën, nuk sjellin helmim me kosto për ata dhe për sistemin shëndetësor. Këto janë mungesa prej vitesh, sepse jua thashë që 1430 subjekte nuk e kishin dhe AKU-ja nuk kishte nevojë të shkonte për inspektim, pasi ky është një dokumentacion që gjendet në dosje dhe sot *online* në databazën e Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ju me të drejtë thoni: “Po ai që e pagoi?!”, por unë ju bëra një pyetje: ishin 1430 subjekte pa licencë dhe u gjobiten vetëm 52, si u gjetën këta 52?!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Po, zoti Ahmetaj, 3 minuta për procedurë.

Arben Ahmetaj- Zonja drejtuese e seancës, kërkoj edhe prononcimin e qeverisë për amendamentin e zotit Beqaj.

Vasilika Hysi- Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Kur të hidhet në diskutim, ministrja ka të drejtë të shprehet, por duhet të mbarojmë me listën e diskutantëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministrja ose ministri përgjegjës. Ministri ka të drejtë ta marrë fjalën sa herë të dojë për të diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Fjalën e ka deputeti Myslim Murrizi. Të përgatitet deputeti Halit Valteri.

Myslim Murrizi - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Së pari, zoti Beqaj, unë nuk e kam vendosur sesi do të votoj dhe mos më paragjykoni. Nga referimi shterues juaji që parashtruat kërkesën dua t'ju them se do të votoj pro nismës suaj, unë nuk jam nga ata që marrin urdhra nga ËhatsApp-i, për një arsye fare të thjeshtë, unë nuk i kisha këto shifra në relacionin shpjegues, por kisha vetëm shifra se sa njerëz kanë kërkuar licencë specifike në vitin 2018 dhe sa në vitin 2019, fakti që nga 1430 subjekte janë gjobitur vetëm 52 dhe, me bindje absolute them se do të jenë gjobitur vetëm pemëkëputurit, ata që s'kanë pasur mundësi, jo grosistët, jo fabrikat e sallamit, jo thertoret, që kanë marrë miliona euro nga ministrat, që kanë qenë këtu dhe jo ata që sjellin margarinë e mish të kalbur nga Argjentina dhe Brazili, por fakirët dhe të vobektit, absolutisht jam dakord me nismën tuaj ligjore. Ndoshta duhet ta zgjeroni gamën për të frenuar sa të mundemi me ligj nga ky Kuvend arrogancën dhe harbutërinë e zyrtarëve të ndryshëm, që mësyjnë si taksidarë, si kusarë dhe si gjobëvënës në dyert e biznesit, të cilëve u kërkojnë haraç dhe ata, të cilët nuk e japin, u presin gjobë për shtetin, ndërsa ata që e kanë lyer rrotën e qerres nuk e kanë emrin në këtë listë. Nuk e di nëse ai drejtori i famshëm, drejtoresha, apo komandanti suprem, çfarë ka qenë ai i AKU-së, ai i aksionit të famshëm të korrik-gushtit, është më i graduar me spaletë apo e keni heqë, por këtë përgjigje do ta doja ta merrja nga zotëria, që është ministër i linjës dhe mbulon AKU-në.

Unë e mbështes nismën tuaj për t'u ardhur në ndihmë të pamundurëve, atyre që nuk kanë pasur mundësi financiare të kënaqin xhepat dhe orekset e arrogancës së administratës së AKU-së në këtë valë behari, që u janë dashur paratë për turizëm për të mësyre me avionë në Anatalia, në Montekarlo apo kushedi se ku.

Ju me të drejtë kërkon që kjo punë të bëhet me ligj, sepse nuk doni ta fusni ministrin e Bujqësisë në praktikën që ka ndjekur ministrja e Financave, e cila ka të drejtë t'i anulohet vetë gjrobat, jo gjoba të këtij lloji, 10-12 milionë euroshe, por gjoba 100 milionë euroshe, të prera nga dogana dhe thotë: "Prit se të them unë kur t'i bësh lekët gati që ta paguash këtë gjobë". Në mënyrë që të mos shkojë edhe Çuçi në këtë variant, ju po e ndihmoni dhe i thoni që të bëjmë një ligj, ku t'u anulohet gjrobat fukarenjve, t'u presim vrullin maskarenjve dhe të mos trokasim më në dyert e bizneseve për t'u kërkuar haraç. Pra, unë shpreh votën time pro nismës tuaj.

Kam dy fjalë brenda pikës së rendit të ditës që po diskutohet. Pas diskutimeve brilante të konstitucionalistëve, që janë në këtë sallë, unë mora vesh edhe një gjë të re nga votimi i dy anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Këtu nuk qenka halli i vakancës në Gjykatë Kushtetuese, por qenka halli i Marsidës. Me thënë të drejtën në fundvitet e komunizmit në çdo dasmë fshati këndohej një këngë: "Marsida, Marsida...". Po mirë more, kryetar i Komisionit të Ligjeve, meqenëse qenka halli i Marsidës dhe Presidenti nuk e thotë dot troç, po ju pse nuk ia thatë troç prokurorit dhe hetuesit të Shkodrës, komunistit Dvorani, që të mos e fuste Marsidën te lista e të privilegjuarve dhe të vinte për kandidim këtu? Çfarë ju pengoi ju, apo edhe ju në serinë e parë keni pasur hallin e Marsidës?! Unë shoh se në listën, e cila i ka shkuar Presidentit të Republikës, jo për ta mbrojtur atë, sepse ai është i votuari juaj, unë kam qenë kundër tij aq vite sa jam në politikë, është Arta Vorpsi e para, Elsa Toska e dyta, Besnik Muçi i treti dhe Regleta Panajoti e katërta. Në këtë listë Presidenti ka dekretuar Besnik Muçin. Në listën që i vjen Kuvendit për t'u votuar është Arta Vorpsi e para, Elsa Toska e dyta dhe Besnik Muçi i treti, por ne do të zgjedhim dy, sepse Besniku është dekretuar nga Presidenti. Në listën që i shkon Presidentit për të votuar numrin 2 të anëtarit të gjykatës është Arta Vorpsi, Fiona Papajorgji, Elda Toska dhe Marsida e famshme. Në listën që i vjen Kuvendit është hequr Marsida dhe vjen Arta Vorpsi, Fiona Papajorgji dhe Elda Toska. Të jem i singertë, Ulsi, kudo që je, kur ta keni terezinë edhe ju, zoti kryetar i grupit të PS-së, me sa shoh unë nuk është halli i Marsidës, me aq sa unë marr vesh dhe pas leksionit të famshëm të dy

konstitucionalistëve tuaj, por më duket se është halli i Artës. Si do t'i bëhet kësaj pune, sepse Arta është e zgjedhur nga të gjitha anët dhe e pazgjedhur nga askush?! Presidenti nuk e ka firmosur atë, por e kanë votuar këta, që punojnë natën te Fletorja Zyrtare të dielën dhe e kanë shpallur fituese meqenëse Presidenti nuk e firmosi. Në listën e parë që kemi ne sot, si Kuvend, dua të di nga dikush që është jurist këtu, Arta është emëruar, Besnikun e ka dekretuar Meta, çfarë kemi për të zgjedhur ne, sepse vetëm Elsa Toska ka ngelur, do të votohet apo do ta zgjedhim? Në listën e dytë që i vjen Kuvendit është prapë Arta, por Arta është emëruar, Marsidën nuk e doni ju, ngelet Fiona, por edhe kjo është emëruar. Pse nuk bëni ju një vendim Kuvendi dhe të thoni që KED-ja e Ardian Dvoranit na ka detyruar që të lajmë dorën formalisht, jo për të zgjedhur, por për të votuar ata që ai ka parashikuar me partishmëri ose si e ka gjykuar ai. Meqenëse keni hallin e Marsidës dhe na thatë se nuk bën, sepse bashkëjeton, unë nuk e di me kë bashkëjeton, sepse po të hapim letrat e bashkëjetimit, nuk e dimë se si del gjysma e kësaj salle, nënë e zezë. Unë nuk e di se me kë bashkëjeton dhe nuk jemi këtu për t'i mbajtur pishën asnjërit dhe as tjetrit, por jemi për të parë atë që gjithsecili nga kandidatët ka deklaruar kur ka kaluar atë veting që është bërë ose nga KED-ja, ose nga KPK-ja, që është shndërruar në "kçk", ose nga KPA-ja.

Po për inspektor të Lartë të Drejtësisë ushtarin e kujt do të votoni ju, vëllanë e kujt do të votoni ju, sekserin e kujt do të votoni ju? Se e keni sjellë në atë farë feje sa nuk ka **hallë** pa votuar vëllanë, kunatin, baxhanakun apo sekserin e Mon Kukaletit, që e keni mbyllur në zyrën e Ramës?! Po për atë çfarë do të thoni? Ai nuk e ka emrin Marsida. Mund ta ketë Marsind, Marsid, Marlind. Ku e di unë se çfarë emri keni ju. Pra, nëse flisni troç për Metën, po për këta vëllezër, motra, baxhanakë, kushërinj apo ushtarë tuajt, a do të guxonit të flisnit (se këtu do të vijmë përsëri, pasi duhen 84 vota edhe për atë), sa guxuat dhe folët për atë prokuror që e internuat me vendim partie në Pogradec dhe e bëtë synet nga gjuha kur kaloi në "kçk" dhe kurrë nuk keni këllqe e kurajë t'u thoni atyre komisionerëve sekserë ta ankimojnë në KPA?!

Ndaj, nëse doni të jeni të moralshëm, të ndershëm me veten, mbani të njëjtin qëndrim për

çdo fenomen, që po jua errëson sytë nëpërmjet mesazheve të *Whatsapp*-it. Kjo është e vërteta e kësaj të famshmeje beteje, demek, ndërmjet Presidentit tuaj dhe maxhorancës suaj. Ai President është zgjedhur vetëm me votat tuaja në vitin 2017 në këtë sallë, dhe ka qenë ortak me ju për katër vjet, siç ishte para katër vjetësh ortak me pjesën tjetër!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Murrizi! Fjalën e ka deputeti Halit Valteri. Të përgatitet deputeti Artur Roshi.

Halit Valteri – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të gjithë këtu e mbajmë mend që para disa muajsh nisi një përplasje mediatike ndërmjet privatit dhe shtetit për produktet e skaduara, abuzimeve dhe cilësisë jashtë kontrollit, ku privati sulmonte shtetin se produktet që shiteshin në treg ishin me hormone dhe të pakontrolluara, ndërsa shteti gjobiste privatit se produktet e tij ishin të skaduara dhe të infektuara.

Epilogu i kësaj përplasjeje ndërmjet shtetit dhe privatit përfundoi me disa reklama në media nga ana e kompanive private, ndërsa shteti nxori ministrin nëpër serra për të provuar domatet dhe perimet, si të ishin gjëja më e shijshme që ai kishte provuar ndonjëherë në jetë.

Unë nuk e kuptoj privatit që kërkon të na e shesë sapunin për djathë, por nuk e kuptoj dot as revolucionin kulturor të qeverisjes suaj të skaduar që i vjen era sa herë nxjerr inspektorët nëpër serra, ndërkohë që kanë për detyrë t'u sigurojnë jetën dhe shëndetin e qytetarëve, jo të mbrojnë bandat që kanë marrë përsipër të helmojnë shqiptarët, sa herë kanë mundësi.

Për fatkeqësinë time dhe të atyre që na ndjekin nga ekrani, më duhet ta pranoj se edhe shteti, edhe privati kanë të drejtë t'i denoncojnë produktet e skaduara, të infektuara me hormone dhe të pakontrolluara. Madje, sipas projektligjit të hartuar po nga ana e qeverisë së revolucionit kulturor alla shëtitje nëpër thertore dhe nëpër serra, u dashka që krimet e bëra ndaj shqiptarëve në kohën e luftës shtet-privat të amnistohen! Pra, shqiptarët të helmohen, ndërsa tregtarët të abuzojnë çdo ditë me jetën e familjeve tona, duke rrezikuar seriozisht shëndetin, madje u dashkan të mos paguajnë kur gjobiten nga organet ligjzbatuese.

Dua t'i bëj thirrje zotit Beqaj me një shprehje nga anët tona: a jeni në tokë të bukës, a ku jeni? Ushqimet e pakontrolluara janë një nga shkaqet e shtimit të pazakontë gjatë viteve të fundit të numrit të të prekurve nga helmimet ose nga sëmundjet e ndryshme të aparatit tretës, deri tek ato tumorale ose të diabetit, ku, sipas raporteve, rastet e prekura nga këto sëmundje shtohen...

Zonja drejtuese e seancës, ju lutem, a mund të mbani qetësi në sallë? Ose të dalin jashtë salle...

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, respektimi kolegun që është në foltore! Faleminderit!

Halit Valteri – Pra, sipas raporteve rastet e të prekurve nga këto sëmundje po shtohen vit pas viti në Shqipëri. Qytetarët po vdesin çdo ditë nga helmimi. Shteti i gjobit dhe ju doni t'i falni. Kanceri është përhapur si grip dhe sëmundjet e brendshme janë shtuar, ndërsa siguria ushqimore ka mbërritur në pikën ku çdokush flet për të. Por askush nuk bën asgjë, përjashtoj disa denoncime publike nga qytetarët e alarmuar me të drejtë, gjë që, më së shumti, u shërben disa botuesve të medieve për të mbushur faqet e tyre me reklama sesa për të zgjidhur hallin që kanë vërtet shqiptarët.

Zoti Ministër, nëse doni të bëni detyrën tuaj dhe atë çka duan shqiptarët, duhet që të gjithë bashkë të ndërmarrim një ligj apo çfarë të doni ju, ose, siç ta mendoni ju që jo vetëm të gjobiten, por edhe të dënohen sipas ligjit përkatës, sepse vërtet nuk po bëjnë vrasje direkt, por çdo ditë po i vrasin shqiptarët.

Në fakt, kam edhe një sfidë për ju, zoti Ministër: të më provoni mua, si çdo qytetari tjetër të këtij vendi, i shqetësuar për shëndetin e tij dhe të familjes se qumështi dhe nënproduktet e tij që tregtohen nga kompanitë më të mëdha të prodhimit në vend dhe që grumbullohen te fshatarët nuk përmbajnë mastit apo infeksione të tjera; se mishi që shkon në tavolinat e shqiptarëve nuk përmban infeksione, si bruceloza dhe tuberkulozi; se perimet dhe frutat nuk janë të rritura me hormone dhe lëndë kimike të rrezikshme, jashtë çdo lloji norme apo standardi; se produkteve që shiten nëpër supermarkete apo brenda qendrave tregtare u hiqet data e skadencës vetëm me një të lëvizur të

gishtit teksa shfaqet një datë e disa viteve më parë, që, nëse je me fat, e disa muajve më parë.

Ndaj, thirrini mendjes, të ndërgjegjësohemi! Ata që kanë abuzuar, të ndiqen penalisht, pra jo vetëm të gjobiten, sepse shqiptarët po helmohen, po vriten dhe po masakrohen nga këta maskarenj që abuzojnë me ushqimet, ndërsa fermerët e ndershëm i hedhin produktet e tyre nëpër kanale dhe as kostot që i kanë mbjellë ato nuk i nxjerrin dot!

Kështu që, të nderuar kolegë, nuk duhet të tallemi me shqiptarët që, kur gjobiten dhe mbyllen subjekte, të cilët u kanë shitur vdekjen për vite me radhë, të sillen këtu në parlament nisma ligjore të turpshme për t'i falur ata njerëz!

Por, zoti Ministër, keni të gjithë mbështetjen time dhe të disa kolegëve të opozitës që të ngrihet një task-force, ku gjoba dhe ndëshkimi të bëjnë të dridhet kushdo që abuzon me cilësinë ushqimore. Gjithashtu, ju kërkoj t'i shihni me më shumë prioritet fermerët që robtohen dhe copëtohen gjithë ditën në punë për kafshatën e gojës, ndërsa ata që shesin dhe abuzojnë fitojnë dhjetëfishin e tyre!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjalën e ka deputeti Artur Roshi.

Artur Roshi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Këtë projektligj të ardhur nga një deputet i maxhorancës mund ta shohim si një kampion të zgjedhur në mënyrë rastësore për të parë gjendjen e biznesit. Prandaj duhet të gjykojmë, nga njëra anë, ngarkesën ligjore që kufizon biznesin dhe, nga ana tjetër, gabaritin e lirisë së funksionimit të tij.

Nëse shohim thjesht kornizën ligjore kushtetuese, nuk do të thotë që ne nuk kemi të drejtë ta përmirësojmë atë për sjellje më të logjikshme ndaj biznesit. Duke ditur që ligji pozitiv ose, thënë ndryshe, Kushtetuta, është integral i të drejtave natyrore të qytetarit, lind pyetja: a kemi ne një legjislacion me përputhshmëri të përafërt me të drejtat natyrore? Unë them se të gjithë biem dakord që ende jo. Atëherë, në pozicionin e ligjvënësve duhet të jemi në krah të të drejtave natyrore të individit dhe të një projektligji të përputhur me to. E drejta natyrore në këtë rast është e drejta për të punuar dhe fituar, që derivojnë nga e drejta për të

jetuar. Në këtë këndvështrim, e vendos veten në krah të së drejtës për të jetuar në krah të atij që ka probabilitetin më të madh të cenohet, në këtë rast, të biznesit.

Le të shikojmë situatën në të cilën ndodhet biznesi. Në këtë plan, ky projektligj shërben si një minibarometër i matjes së presionit të atmosferës së pushtetit që ndien biznesi prej qeverisë. Bizneset e prodhimit dhe të shitjes së mallrave shtazore kanë pasur një detyrim ligjor për t'u pajisur me licenca specifike, të themi, profesionale. Por për gati nëntë vjet Autoriteti i Kontrollit të Ushqimit nuk e ka kërkuar një gjë të tillë dhe një ditë aksioni vendos gjoba që i fundos, duke i falimentuar këto biznese me gjoba nga 1 milion lekë deri në 2 milionë lekë.

Mirë biznesi që ka një përgjegjësi ligjore edhe kur është i painformuar, po shteti, në këtë rast, AKU-ja, nuk ka përgjegjësi ligjore për mosushtimin e detyrës, pra të kontrollit për nëntë vjet rresht? Në këtë rast, biznesi është viktimë, ndërsa shkelësi i vërtetë është shteti.

AKU-ja e ka shpërdoruar, në fakt, detyrën e saj për nëntë vjet me radhë me moskontrollin e saj dhe tani shkel në mirëbesim atë që i ka dhënë në heshtje biznesit. Mosinformimi i biznesit tregon se është hartuar një ligj pa pyetur grupin e interesit. Pra, këtë detyrim të pazbatuar të ligjvënësit ne mund ta korrigjojmë duke i falur gjobat biznesit.

Le të marrim shkas nga ky rast dhe t'i bëjmë thirrje ministres së Financave të sjellë një projektligj për faljen e gjobave të të gjitha bizneseve pa përjashtim, në mënyrë që t'i lehtësojmë ato nga ngarkesat fiktive që ka krijuar sistemi fiskal.

Duhet të pranojmë se klima e biznesit është shumë e keqe. Këtë e tregon edhe raporti i fundit ndërkombëtar, ku pohohet se 34,5% e bizneseve kanë pranuar që zarfë i ryshfetit shpëton përkohësisht nga goditja e shtetit.

Rasti që flasim nuk mund të jetë jashtë frymës së këtij raporti. Ky është korrupsioni që i merr frymën ekonomisë dhe mbijetesës së bizneseve. Urdhrat tatimore të bashkive apo të tatimeve të shtetit, titujt ekzekutivë duhet të marrin fund. Me tekat e një inspektori bllokohen llogaritë e çdo biznesi apo të çdo individit. Titujt ekzekutivë i kanë suprimuar gjykatat. Për gjobat duhet të vendosë gjykata se kush i paguan, sepse deri sot abuzuesi është i paravendosur; në çdo

rast është biznesmeni. Pra, gjobat duhen adresuar nëpërmjet gjykatës tek të dyja palët: ose te biznesmeni, ose tek inspektori.

Investimet e huaja po shterojnë. Investimi i brendshëm është drejt minimumit. Konsumi po bie. Gjendja ekonomike është në limitet e mbijetesës. Kjo do të thotë që ekonomia e vendit ka marrë rrugën e depresionit ekonomik. Këtë gjë, sipas meje, pothuajse e certifikon edhe projektbuxheti i vitit që vjen, i cili është duke ardhur. Prandaj, ju bëj thirrje të jemi të matur dhe të ripërpunojmë një ligj gjithëpërfshirës për të gjitha bizneset, për të ulur riskun e tyre që kanë për arsye të paarsyeshme. Ju ftoj ta kthejmë ligjin për ta plotësuar dhe për ta bërë atë me një efekt vërtet real për biznesin dhe për ekonominë e vendit.

Pamë dje Kryeministrin, i cili foli për një politikë ekonomike pa mure në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ndërkohë që në vendin e tij ka ngritur në mes të bulevardit një mur të madh ideologjik me fortësinë e së shkuarës; një paradë të vdekur të simboleve të gjalla të komunizmit, poshtë së cilës jemi të detyruar të kalojmë përditë. Ndërkohë që në Gjermani po kujtohet dita e rënies së Murit të Berlinit, ne kemi ngelur ende peng i përçarjeve ideologjike, të cilat i ngritën komunistët më 1941-shin. Ky gjest vulgar është një provokim i ulët që u bëhet 50% shqiptarëve që zgjodhën vuajtjen dhe jo nënshtrimin ndaj diktaturës.

Shohim një festim të bujshëm të 75-vjetorit të pushkatimit, në fakt, të pushtimit të Shqipërisë nga komunistët, ndërkohë që pensionistëve nuk keni t'u jepni një shpërblim minimal për Vitin e Ri. Kjo është jo vetëm denigruese, por edhe shumë qesharake. Komplimente organizatorëve, të cilët i kanë tejkaluar paradat e Enverit...

(Ndërhyrje nga salla)

Lind një pyetje shumë logjike: a duhet që politika t'i flasë logjikës për sa kohë shqiptarët do të vuajnë psikologjinë e mureve.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Këtu përfundon lista e diskutantëve. Vazhdojmë me diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka deputeti Arben Ahmetaj, i cili është diskutanti i fundit. Pasi deputeti të mbarojë fjalën do të bëjmë pushim,

sepse Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka kërkuar mbledhje grupi.

Më pas do të vazhdojmë me procesin e votimit.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë do të mundohem të jem konciz në ato që do të them. Ndërkohë, po i referohem asaj që deputeti nismëtar tha edhe në Komisionin e Ekonomisë, ku pranoi edhe pikëpyetjen e tij për kushtetutshmërinë dhe antikushtetutshmërinë. Deputeti iniciator kërkon faljen e gjobave për një periudhë shumë të ngushtë, 1 korrik - 31 gusht, për afërsisht 75 biznese, të cilat janë gjobitur për cenim të sigurisë ushqimore me pretendimin se nuk e njohin ligjin. Pra, në këndvështrimin tim, ky është thelbi i gjithë amendamentit.

Pavarësisht diturisë së Komisionit të Ekonomisë për kushtetutshmërinë, një pjesë e mirë e tyre janë financiarë, ekonomistë dhe juristë, besoj që Kushtetuta nuk është bërë që të lexohet dhe të kuptohet vetëm nga specialistë të kushtetutshmërisë, sepse shpesh kemi parë çfarë kanë bërë me deformimin e saj.

Thelbi është në tri shtylla:

Së pari, ka pabarazi, pra, të falim gjobat për 75 biznese, ndërkohë që Kryeministri në atë periudhë ka iniciuar antiinformalitetin, i fokusuar, gjithashtu, edhe te siguria ushqimore. Siguria ushqimore nuk ka çmim, nuk ka as falje për padituri, prandaj gjobat janë 1 milion apo 2 milionë dhe jo si gjobat e tjera që kanë proporcionalitet. Ato kanë koncept parandalimi dhe siguria ushqimore është e panegociueshme në këtë aspekt.

Së dyti, nuk mund të justifikosh një sipërmarrje, nuk e kemi justifikuar kurrë një sipërmarrje, se nuk njeh ligjin.

Së treti, po t'i referohemi vendimit të vitit 2009, në aspektin e licencimit nuk ka ndryshuar kurrë. Pra, nuk ka arsye që sipërmarrjet të mos e njohin detyrimin ligjor për licencim.

Deputeti iniciator iu referua një kundërshtie interesante që ia vlen të diskutohet në nivel administrativ, por ne e prekëm edhe në nivelin legjislativ. Deputeti pyeti pse AKU-ja ka vendosur 75 gjoba, ndërkohë që brenda asaj periudhe, në mos gaboj, janë regjistruar rreth 1570 biznese. Nuk është argument. Do të thotë që në kapacitetin e vet AKU-ja duhet të bëjë punë më të mirë për të formalizuar të gjithë

elementet e sigurisë ushqimore. Debatimi kështu mund të vazhdojë gjatë, sepse është edhe problemi i asaj që ne i referohemi si *moral hazard*.

Ta shpjegoj shumë thjesht për qytetarët: kur një sipërmarrje shkel ligjin, sidomos atë të sigurisë ushqimore, dhe gjithmonë ka një dalje në parlament për falje gjombash, tendenca për ta përsëritur e ribërë atë gabim është e madhe. Pra, ky është risku moral në aspektin e zbatueshmërisë së ligjit. Prandaj, ne e rrëzuar njëzëri në komision.

Gjithashtu, dua t'ju them edhe një element shumë të rëndësishëm. Qeveria, nëpërmjet zëvendësministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u pozicionua kundër amendamentit të kolegut Beqaj në komision. Pasi diskutuam të gjitha këto që unë përmenda më sipër të shtyllëzuara dhe jo të detajuara, ne i kërkojmë dhe i sugjerojmë Kuvendit ta rrëzojë nismën.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr Kryetari i Kuvendit.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Këtu përfundon diskutimi parlamentar për çështjen e fundit.

Po, zonja Hajdari, çfarë keni?

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk e keni emrin të regjistruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Dakord, te çështja e parë.

Rudina Hajdari – I nderuar zoti Kryetar,

Kam një propozim për projektvendimet që do të votojmë sot. I bëj apel parlamentit të tregojmë një vullnet më të gjerë, të gjejmë një gjuhë të përbashkët, qoftë edhe me Presidentin. Sugjeroj që ndoshta mund ta ndërpresim seancën dhe t'i kërkojmë Presidentit që të mos e çojmë për zgjedhjen e kandidaturave të Gjykatës Kushtetuese drejt bllokimit dhe një konflikti tjetër të panevojshëm për vendin tonë.

Mendoj se në këtë mes kanë faj të gjitha palët, sepse të gjitha palët nuk po ndjekin procedurat, se ka një boshllëk në ligjin për Gjykatën Kushtetuese, prandaj ulja për të bërë një marrëveshje dhe për të gjetur një konsensus të gjerë për kandidaturat dhe mosbllokimin e tyre do të ishte zgjidhja më e duhur për vendin tonë, sepse, në fund të fundit, po flasim për ngritjen e Gjykatës Kushtetuese, një nga organet më të

rëndësishme të vendit tonë. Gjithashtu, për herë të parë në historinë tonë, të krijojmë një precedent për të gjetur gjuhën e përbashkët për këtë pikë.

U bëj thirrje edhe një herë të dyja palëve të gjejnë gjuhën. Edhe Presidenti, në këtë rast, nëse ka një kandidaturë të fshehur, të thotë publikisht që nuk është ky synimi im, por unë jam tërësisht gabim me procedurën që është ndjekur nga KED-ja, e cila ka sjellë dy lista në të njëjtën datë dhe për Presidentin kjo pikë bie ndesh me Kushtetutën. Pra, duhet të ketë një përzgjedhje nga Presidenti, më pas nga Kuvendi dhe më pas nga Gjykata e Lartë, që, në fakt, nuk ekziston, ka ngelur pezull.

Pra, është e qartë që e gjithë procedura ka boshllëqe, është e qartë që ne po shkojmë drejt një konflikti të panevojshëm. Prandaj, nëse vërtet duam ta kapërcejmë këtë konflikt, është mirë ta ndërpresim seancën, të bisedojmë me Presidentin për këtë çështje, Presidenti nga ana tjetër të tregojë vullnetin e tij të plotë se mënyra se si ai po procedon nuk është, në fakt, për një preferencë të caktuar të një kandidature në Gjykatën Kushtetuese, por është në mënyrë strikte, sepse KED-ja me mënyrën si i ka dërguar listat te Presidenti ka shkelur procedurën.

Pra, e përsëris edhe një herë, unë mendoj që të gjitha palët kanë faj dhe po i bëjnë hile njëra – tjetrës. Është e kotë të vazhdojmë me këtë procedurë, sepse pas kësaj seance do të jetë përcaktuese mënyra si do të ngrihet Gjykata Kushtetuese. Nëse ne vërtet duam të kemi një Gjykatë Kushtetuese me anëtarë që kanë dinjitet dhe që integriteti i kësaj gjykate të mos cenohet në të ardhmen, duhet të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe të mos krijojmë një precedent, që do të ishte në dëm, si të Gjykatës Kushtetuese, si të vendit tonë, si dhe të çdolloj gjëje tjetër, pra, të mos vazhdojmë të njëjtën histori që kemi bërë gjithmonë: ta politizojmë këtë çështje, ta çojmë drejt bllokimit, drejt cenimit të çdo institucioni që kemi në vendin tonë dhe drejt denigrimit të reformës në drejtësi.

Pra, ky është apeli im. Uroj ta merrni në konsideratë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Këtu përfundojmë me diskutimet për çështjet që kishim në rendin e ditës së sotme. Do të vazhdojmë me procesin e votimit.

Zoti Balla, keni kërkuar pushim?

Taulant Balla - Po

Gramoz Ruçi – Atëherë, ju lutem, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të vijë në mbledhje, kurse kolegët e tjerë të mos mërzhiten, sepse votimi do të fillojë menjëherë.

(Bëhet pushim)

(Pas pushimit)

Gramoz Ruçi – Kolegë deputetë, kolegët e opozitës kërkojnë 5 minuta kohë. Pozita të lirojë sallën.

Në fakt, ju sallën andej e kishit dhe mund të vazhdonit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdoni!

(Pas pushimit)

Gramoz Ruçi - Kolegë deputetë, uluni!

Atëherë, rifillojmë seancën!

Do të fillojmë me votimin.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Të hiqen kartat e deputetëve që nuk janë këtu: Gjuzi dhe Piciri.

115 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Projektligji kërkon shumicë absolute të votave për miratim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Ju lutem, zoti Rama, mund të votoni!

Mbyllet votimi.

110 vota pro. Asnjë kundër, një abstenim, pesë deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Kalojmë në votimin nën për nën me kartonë sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

110 pro. Asnjë kundër, një abstenim, pesë deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet.

Projektligji “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor”. Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat është shprehur për mosmiratimin në parim të tij. Në mbështetje të nenit 38, pika 6, të Rregullores: “Kur komisioni përgjegjës vendos mosmiratimin në parim të projektligjit, çështja vendoset nga seanca plenare”.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

31 vota pro, 69 kundër, 8 abstenime, 8 deputetë nuk kanë votuar.

Nuk miratohet.

Kalojmë në projektvendimin “Për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e plotë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 12.02.2018”.

Para se të filloj votimin, më lejoni të sqaroj (për transparencë për publikun dhe për kolegët deputetë, para se të vendosin), se sot jemi në një seancë, të cilën e kemi zhvendosur nga dita e enjte, pra seancën e ditës së enjte po e bëjmë ditën e hënë, (seancën e datës 14 e zhvendosëm në datën 11 nëntor); kjo për të plotësuar afatin 30-ditor, i cili e detyron Kuvendin të shprehet lidhur me kandidaturat që KED-ja i ka çuar Kuvendit për miratim apo për mosmiratim.

Së dyti, të gjithë deputetët janë vënë në dijeni që Presidenti i Republikës ka bërë një arsyetim të gjatë me përfundimin se ngrin ushtrimin e kompetencës së vet derisa të shprehet Kuvendi. Kjo letër u është vënë në dispozicion të gjithë deputetëve.

Pasi më ka ardhur kjo letër, i jam drejtuar organit të emërtesës, që në rastin konkret është KED-ja, për informacion të mëtejshëm në zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë. KED-ja i është përgjigjur kërkesës së bërë nga Kuvendi me arsyetimet përkatëse dhe ka dalë në konkluzioni se, duke mos u shprehur brenda 30 ditëve që Kushtetuta i lejon Presidentit, kandidatja e parë automatikisht është e zgjedhur anëtare e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, duke pasur parasysh, që siç u shprehën edhe sot, kishte vlerësime politike dhe procedurale, ditën e

shtunë, në ushtrim të kompetencave të mia si kryetar, i jam drejtuar Këshillit të Legjislacionit, i cili është i vetmi institucion, mekanizëm, që ka Kuvendi, në një farë mënyre një gjykatë kushtetuese në miniaturë, e cila jep mendimin për kushtetutshmërinë e projektligjeve apo për procedurat parlamentare.

Këshilli është mbledhur dhe ka konkluduar që, duke parë propozimet e ardhura nga KED-ja, duke iu referuar Kushtetutës, duke iu referuar letrës së Presidentit, duke iu referuar letrës që unë i kam bërë KED-së, duke iu referuar përgjigjes që KED-ja i ka kërkuar Kuvendit, duke iu referuar procedurës që tashmë do të votojmë, ka arritur në konkluzionin që procedura është tërësisht kushtetuese dhe procedurale. Prandaj, me lejon të vazhdoj me kryerjen e votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Ky projektvendim në mbështetje të nenit 125, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, kërkon shumicë të cilësuar votash për miratim, pra 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit ose të paktën 84 vota.

Ju rikujtoj se Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës, ka miratuar me shumicë votash raportin për vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe renditjen sipas vendimit të KED-së:

Arta Vorpsi, Elsa Toska dhe Besnik Muçi, i cili është emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11313, datë 15.10.2019.

Në listën e paraqitur nga KED-ja dhe që i është përcjellë seancës plenare për votim, kandidatja e parë në listë, zonja Arta Vorpsi rezulton të jetë shpallur e emëruar për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04. 03. 2019, pas plotësimit të afatit tridhjetëditor nga data e paraqitjes së listës së KED-së në Presidencë dhe në mungesë të ushtrimit të dekretimit brenda këtij afati nga Presidenti i Republikës. Gjithashtu, vendimi i KED-së është botuar në Fletoren Zyrtare 151.

Kandidati i tretë, siç u shpreha më lart, është emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese me dekretin të Presidentit të Republikës nr. 11313,

datë 15. 10. 2019, publikuar po ashtu në Fletoren Zyrtare 144, 2019.

Pra, kandidatja që mbetet nga lista me tre kandidatë të dërguar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, është vetëm Elsa Toska.

Këshilli për Legjislacionin, në mbledhjen e tij lidhur me kushtet për kushtetutshmërinë e procedurës së votimit, i rekomandon seancës plenare që procedura e parashikuar për t’u ndjekur në seancë plenare është konform akteve ligjore.

Për më gjerësisht, të gjithë keni përpara materialet e cituara më lart, prandaj më lejoni të hap votimin.

Hapet votimi. Votimi është me elektronikë dhe i fshehtë, me kërkesën e shtatë deputetëve.

Hapet votimi i fshehtë...

(Debat në sallë)

Urdhëro?

(Debat në sallë)

Ju lutem edhe një herë: mos bëni...

(Debat në sallë)

Kërkesa për votim është fiksuar si e fshehtë. Mënyrat e votimit janë dy: ose me letër, ose me elektronikë. Kërkesë për votim me letër nuk ka, sepse duhen 34 firma deputetësh. Kërkesa për t’u votuar me elektronikë është depozituar me firmat e shtatë deputetëve.

Kush është dakord që votimi të bëhet i fshehtë, me elektronikë?

Në rregull!

Atëherë hapet votimi i fshehtë, me elektronikë, për zonjën Elsa Toska.

Vazhdon votimi për ata që s’kanë votuar.

Mbyllet votimi.

105 vota pro. 2 kundër. Asnjë abstenim. Nuk kanë votuar vetëm dy deputetë.

Zonja Elsa Toska shpallet fituese për anëtare e Gjykatës Kushtetuese, pas votimit të Kuvendit.

Projektvendimi “Për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese”, vakancë e plotë, e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 4. 03. 2019.

Edhe ky projektvendim, në mbështetje të nenit 125, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10. 02. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” kërkon shumicë të cilësuar votash për miratim, pra 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, ose të paktën 84 vota.

Edhe një herë ju rikujtoj, që Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës, e ka miratuar me shumicë votash raportin për vlerësimin e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe renditjen e tyre sipas vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi: 1- Arta Vorpsi. 2-Fiona Papajorgji. 3- Elsa Toska.

Nga lista e paraqitur prej KED-së, që i është përcjellë seancës plenare për votim, kandidatja e parë, zonja Arta Vorpsi, siç thashë, rezultoi të jetë shpallur e emëruar për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04. 03. 2019, pas plotësimit të afatit tridhjetëditor nga data e paraqitjes së listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në Presidencë, në mungesë të ushtrimit të dekretimit brenda këtij afati nga Presidenti i Republikës. Vendimi i KED-së është i botuar gjithashtu në Fletoren Zyrtare nr. 151.

Kandidatja, zonja Elsa Toska, u zgjodh sot anëtare e Gjykatës Kushtetuese nga votimi për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi në datën 12. 02. 2018, pra të korrigjohet nga shërbimi i administratës data 12 në 11.

Kandidatja, nga lista me 3 kandidatë të dërguar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që i paraqitet për votim seancës plenare, është zonja Fiona Papajorgji. Këshilli për Legjislacionin, edhe në këtë rast, në mbledhjen e tij lidhur me kushtetutshmërinë dhe me procedurën e votimit, i rekomandon seancës plenare të ditës së sotme që procedura e parashikuar për votim, e ndjekur nga kjo seancë është konform Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores.

Hapet votimi për zonjën Fiona Papajorgji.
Mbyllet votimi.

Janë 105 vota pro, 3 kundër, 8 abstenime, 2 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet kandidatura e zonjës Fiona Papajorgji.

Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 12, pika 1, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash.

Ju rikujtoj se komisioni përgjegjës në lidhje me kandidaturën e zonjës Pranvera Strakosha

është shprehur se ajo i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga ligji “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, kriteret e papajtueshmërisë së funksionit të Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, si dhe kriteret e meritës profesionale.

Procedura e votimit është e fshehtë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 95 vota pro, 4 kundër, 9 abstenime, 10 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet kandidatura e zonjës Pranvera Strakosha.

Njoftim/miratimi me mirëkuptim i kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim.

Ju njoftoj se ditën e premte u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi për draftkalendarin 3-javor për periudhën në vijim. Në Konferencë pati mirëkuptim dhe, për pasojë, në mbështetje të nenit 27, pika 3, të Rregullores kalendarit i njoftohet Kuvendit. Kalendarin do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Njoftim/miratimi me mirëkuptim i kalendarit të veçantë të shqyrtimit të projektligjit të buxhetit të shtetit, si dhe i projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Ju njoftoj se ditën e premte u mbledh Konferenca e Kryetarëve, ku ministrja e Financave dhe Ekonomisë, zonja Anila Denaj, prezantoi projektbuxhetin për vitin 2020. Në lidhje me kalendarin e veçantë të shqyrtimit të këtij projektligji në komisione dhe në seancë plenare pati mirëkuptim dhe, në mbështetje të Rregullores, kalendarit i njoftohet Kuvendit. Kalendarin do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Ky projektligj kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Zoti Abazi, zoti Gjetani dhe zoti Ylli nuk kanë votuar.

107 vota pro, 11 abstenime.

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 1, ju njoftoj se deputeti Alket Hyseni, 24 orë para seancës

plenare, ka paraqitur amendimin lidhur me saktësimin e titullit të projektligjit, e cila reflektohet edhe te neni 1.

Zoti Hyseni, a doni ta parashtroni?

Po, fjala për ju.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke qenë se në preambulën e Konventës, e cila ka ardhur për miratim, figuron fakti që shteti shqiptar e ka nënshkruar këtë Konventë më 20 prill të vitit 1929, po ashtu, referuar edhe nenit 17 të ligjit “Për marrëveshjet ndërkombëtare”, i cili përkufizon ratifikimin si një akt në të cilin Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga kjo marrëveshje, që është e nënshkruar më parë prej saj, pasi kemi rënë dakord me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila në draftin origjinal e ka parashikuar si ratifikim, kërkoj ndryshimin e propozuar në amendament për nenin 1 të këtij projektligji. Pra, kërkoj të ndryshohet titulli i projektligjit dhe të bëhet “Për ratifikimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”. Pra, termi “aderim” të zëvendësohet me termin “ratifikim”. E njëjta gjë të bëhet edhe në nenin 1, ku të pasqyrohet termi “ratifikim” në vend të termit “aderim”.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – E hedhim në votim amendamentin e paraqitur nga zoti Hyseni.

Kush është dakord?

Faleminderit!

Miratohet!

Hapet votimi në parim me elektronikë.

(Diskutime pa mikrofon)

Edhe një herë për IT-në: nuk ishte votimi në parim, as në tërësi, por ishte votimi për ndryshimin e titullit nga “aderim” në “ratifikim”, siç e argumentoi zoti Hyseni.

Pra, tani do të kalojmë në votimin në parim, më pas në votimin nën për nen dhe në tërësi. Prandaj, elektronika të hapë votimin në parim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

106 vota pro.

Kalojmë në votimin nën për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 100 vota pro, 17 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin nr. 19/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”, ku deputeti Erion Piciri caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe deputeti Edmond Stojku caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 105 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 12 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet.

Këtu përfundon votimi për çështjet, që kishim në rendin e ditës së sotme.

Vazhdojmë me diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjala për deputetin Kostaq Papa.

Kostaq Papa – Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke marrë shkas nga problematika komplekse në zonën e Unazës së Re të Tiranës dhe nga zgjidhja e gabuar nëpërmjet forcës, problem të cilin e trajtuam edhe në seancën kur folëm për problematikat e qytetarëve, duke dhënë edhe mënyrën e zgjidhjes së problemit nëpërmjet dialogut, ndërmjetësimit dhe shpалosjes së planit urban dhe jo planit korruptiv, dua t’i bëj edhe një herë thirrje qeverisë për një zgjidhje të drejtë të problemit dhe për mosshkelje të të drejtave themelore të qytetarëve. Më kryesorja është se qeveria nuk duhet t’i nxjerrë në rrugë familjarët, fëmijët, pleqtë dhe të pamundurët, por duhet t’ua legalizojë pronën. Unë jam në dispozicionin të qeverisë, si një ndërmjetës i familjeve të zonës së Unazës së Re, me kusht që të ndalohet goditja mbi familjarët dhe të përpiqemi për një zgjidhje të drejtë të problemit. Problemi është kompleks, por ka edhe zgjidhje, e cila nuk është forca, por është komunikimi me qytetarët.

Gjithashtu, do të ndalem edhe në disa probleme të ngjashme në bashkitë e tjera të vendit, por në përmasa më të vogla. Situata të tilla përplasjeje midis qytetarëve dhe

administratës së pushtetit lokal në lidhje me privatizimet e objekteve të ndërtuara në gërmadhat apo gjurmët e objekteve të vjetra ka pothuajse në të gjithë vendin. Problemet e këtyre familjeve të pastreha më shumë se nga varfëria kanë ardhur nga veprimet joligjore dhe korruptive të personave të pushtetit lokal dhe qendror, të cilët kanë marrë pjesë në këto procese privatizimi dhe pronësi. Korrupsioni i tyre i hapur mbi familjarët, të pamundurit dhe atyre në gjendje të rënduar socialekonomike ka bërë që këto procese të mos kryhen plotësisht. Pothuajse në çdo qytet ka pasur objekte, që kanë qenë jashtë përdorimit, në të cilat, me kalimin e kohës, familjarët e këputur nga gjendja ekonomike, në ngrehinat apo në mbetjet e gjurmëve të tyre, kanë ngritur kasollet apo barakat, më pas banesat e tyre të skamjes, si një përpjekje për të futur kokën dhe fëmijët e tyre.

Edhe pse në shumicën e rasteve këto objekte janë të ngjashme, janë përdorur variante dhe mënyra të ndryshme gjykimi, vlerësimi, përfundimi apo zvarritjeje. Edhe pse qytetarët u vendosën në këto rrënoja, në këto gjysmaobjekte joekzistente (konkretisht ata janë vendosur në troje dhe jo në objekte apo banesa të pushtetit lokal), ai që dirigjon korrupsionin e zyrtarëve të pushtetit lokal u kërkon atyre të paguajnë për objektin që ka ekzistuar aty para viteve '90. Në fakt, në momentin kur këta qytetarë kanë vendosur të ngrenë kolibet e tyre në këtë truall, ata nuk kanë gjetur aty objekte, sepse ato ishin shembur dhe nuk ekzistonin. Kështu, në të drejtën e Zotit, jo në të drejtën e bashkive, këta qytetarë nuk mund t'u paguajnë bashkive ajrin apo qiellin, por vetëm truallin që kanë zënë. Pra, që të paguash një objekt fillimisht duhet të banosh në të, por, nëse ky objekt nuk ekziston dhe duhet të ndërtosh diçka që të fusësh kokën, atëherë çfarë duhet t'i paguash bashkisë?! A duhet ta paguash atë që nuk ekziston, atë që e ke bërë me djersë dhe me gjak, apo truallin që ke zënë?! Sigurisht, truallin që ke zënë duhet ta paguash. Të mbërthyer në këtë gangrenë, janë me qindra familje në të gjitha bashkitë e vendit. Këto probleme zgjidhen me një ligj, në mënyrë që t'i jepet fund odisesë së qindra familjeve dhe t'i jepet fund korrupsionit në të gjitha bashkitë e vendit.

Probleme të tilla ka në Tiranë, në Durrës, në Elbasan, në Lushnjë, në Fier, në Vlorë, në

Gramsh, në Sarandë, në Delvinë e të tjerë. Duke zgjidhur këtë problem, zgjidhet edhe problemi i pensionistëve invalidë në Gramsh. Një pensionist invalid, përveç rritjes së pensionit, më kërkoj që ta ndihmoja për të pronësuar objektin e tij si i pastrehë në përpjekje për një jetë më të mirë. Po ashtu, një qytetar tjetër nga Gramshi, me mbiemër Çekrezi dhe 9 familje pronare kërkojnë të posedojnë pronësinë e pronës së tyre, sepse vazhdojnë të mbeten si dikur ish-pronarë. Ndërkohë, bashkia apo Ministria e Mbrojtjes pronat e tyre, që dikur kanë qenë ngrehina ushtarake, ua jep të preferuarve për korrupsion, sepse, gjoja, këta biznesmenë bëhen garantë për të gjeneruar vende pune dhe për të ulur papunësinë e lartë të këtij qyteti të vështirë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Papa!

Fjala për zotin Kujtim Gjuzi.

Kujtim Gjuzi - Faleminderit, zoti Kryetar!

Le ta mësojnë të gjithë shqiptarët se sot, megjithëse e kërkoja fjalën për procedurë, Kryetari më tha se nuk e kisha të drejtën e fjalës, sepse ishte momenti i procesit të votimit. Dakord!

Zoti Gramoz, ju jeni shumë strikt në momente të caktuara dhe shumë mirë bëni, por shqiptarët duhet ta dinë se Kujtim Gjuzi e do Gjykatën Kushtetuese, por nuk do një Gjykatë Kushtetuese me njerëzit që zgjedh Kryeministri Edi Rama.

Ju, qytetarë të Republikës së Shqipërisë, duhet ta dini se Gjykata Kushtetuese me votimet e sotme shkon drejt monizmit, pra shkon drejt kontrollit total të Kryeministrit, i cili kontrollon financat e vendit, ka të drejtë t'i kontrollojë, sepse është Kryeministër; kontrollon shtypin, nuk ka të drejtë, edhe pse është Kryeministër; kontrollon bashkitë, megjithëse i ka kthyer në komitete ekzekutive dhe tani do të kontrollojë edhe Gjykatën Kushtetuese, sepse njerëzit e tij oligarkë grabitën pronat, trojet e çdo shqiptari, shkatërruan shtëpitë e shqiptarëve, nxorën nga shtëpitë e tyre njerëzit në fund të bulevardit "Zogu i parë", përmes kryetarit të bashkisë Erion Kuplaras.

Zoti Kryetar, do t'ju them juve dhe shqiptarëve se duhet ta mësojnë se opozita parlamentare duhet të kishte të paktën kandidaturë rivale me kandidaturat, por sot përsëri, këtë e them me keqardhje, brenda grupit

të të djathtëve, të opozitës së re, lëvizin vota. Ky është një gabim i rëndë, kjo është një blerje e demokracisë dhe shkuarje drejt diktatit dhe drejt demokracurës.

Ju mendoni se duke kaluar muajt, koha dhe vitet do të shuhet dhe do të harrohet çdo gjë, sikurse me opozitën e rrugës, por ju garantoj dhe jo vetëm unë, por edhe të gjitha këto zonja dhe zotërinj që janë këtu, që ndonjëherë i merrni me shaka, se kjo Gjykatë Kushtetuese, me këto vota që mori sot... Në mënyrë absolute nuk kam asgjë me personat që u votuan, por të paktën një CV-i duhet t'u vihej deputetëve që të shikonin se për kë do të votonin, përse do të votonin pro, përse do të abstenonin dhe përse do të votonin kundër.

Në këto kushte, i nderuar zoti Kryetar, edhe për efekt të etikës, që të mos kesh shans herë tjetër të thuash se Kujtim Gjuzi nuk është etik, çfarë të kushton një procedurë me ia dhënë Kujtim Gjuzit fjalën dy minuta? Çfarë të kushton? Je Kryetar i Kuvendit zotëri. Edhe në kuvendin e Labërisë nga vjen ti, nëse ndonjëri në fund të odës së burrave kërkon të flasë, kryekuvendari i thotë: "Po, mund të flasësh", dhe në fund i thotë: "Jo, se do ta bëj kështu siç them unë, sepse unë jam kryetari kuvendar dhe me veto vendos si më do qejfi". Ashtu siç vendos Partia Socialiste, e cila, e theksoj se ka 58 vota dhe asnjë votë më shumë, të gjitha votat e tjera janë të blera. 24 vota janë blerë në vitin 2017, ku kundërshtia ime ka qenë me Lulzim Bashën, i cili të njohu kryetar aty. Kjo është e drejtë e tij. Sot nuk është këtu dhe nuk është vendimmarrës, por ne të tjerët jemi vendimmarrës, edhe me votën kundër.

Unë po ju them se ne do të rishikojmë në momentin e duhur, në kohën e duhur çdo anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ata që kanë probleme, por edhe ata që u votuan sot. Prandaj i ftoj të mos e pranojnë votimin në këtë formë, pa kandidaturë rivale, sepse biem në monizëm, duam apo nuk duam. Nuk do të ketë hapje me BE-në dhe unë do të punoj kundër minutë për minutë derisa në këtë parlament të vendoset demokracia, vota e lirë dhe mirëkuptimi.

Ne jemi shqiptarë dhe i duam trojet tona që nga gjiri i Artës, pavarësisht se janë jashtë, si pasojë e Konferencës së Londrës.

Po, po, zoti Kryetar, do të them herën tjetër përsëri "I nderuar", nëse do të hapësh hapësira dhe hapësirat i ke.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kam dy sqarime modeste. CV-të e kandidatëve të Gjykatës Kushtetuese janë të depozituara në Kuvend dhe në të gjitha tryezat, prandaj referojuni atyre. Në parlament është i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga KED-ja, pa përjashtim, prandaj nuk qëndron akuza e dytë.

E dyta, lidhur me mënyrën e votimit për kandidaturat që ishin për Gjykatën Kushtetuese, është zhvilluar një debat, ku morën pjesë mbi 20 deputetë. Ju, zoti deputet, nuk keni qenë në sallë.

E treta, kur fillon procesi i votimit, nuk ka më diskutime, por votim.

Faleminderit për mendimet që shprehët!

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

(Seanca u mbyll në orën 14:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**